

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7489 E enjte 5 Prill 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** **Ditës**
Për vlerësuesit e gjendjeve ekonomike ka qenë thjesht çështje kohe se kur do të fillonin protestat në vend. Ato plasën pas një vendimi të qeverisë për ...
Vijon në faqen 20

Nga BEN ANDONI
Edi Ramën, ashtu si Berishën, do e mundë transparenca


Opinion **i** **Ditës**
Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë po ndjek me kujdes zhvillimet e fundit në vendin tonë. Në mënyrë të veçantë në fokusin tonë kanë qenë ...
Vijon në faqen 21

Kisha Katolike: Qëndrimi ynë për Rrugën e Kombit



Flet vëllai i viktimës: Po kërkoj eshtrat
Krimi horror në Fier, Donjet Beqiraj: Dua të gjej kokën e vëllait për të bërë ceremoninë

36-vjeçari u masakrua nga shoku i ngushtë, familjarët: Të zbardhet e gjithë ngjarja
Nga IERVIS KUCI
Afro një muaj pas gjetjes së eshtrave të 36-vjeçarit Kreshnik Beqiraj në fshatin Daullas të Fierit, vëllai i viktimës ka dhënë detaje tronditëse lidhur me ngjarjen makabre të ndodhur më 22 qershor të vitit që shkoi...

TAKSA E RRUGES SE KOMBIT, BASHA: SOT NIS MOSBINDJA CIVILE, BLOKOJME RRUGET

RRUGA E KOMBIT, QEVERIA NEGOCION PER ULJE ÇMIMI

Gjykata lë në burg 11 kuksianë nga 23 të ndaluar. Deputetët e PD përplasen me policinë, gjakoset Spaho: Na dhunuan. Rama s' do ia hedhë lehtë



(Në foto) Seanca për masën e sigurisë në Gjykatën e Tiranës, për 23 të arrestuarit pas protestës në Rrugën e Kombit

“SHEMBJA” E KULTURES
Kërkesa e Ndrenikës çon aktorët te Meta: Çfarë na premtoi presidenti për teatrin
Në faqet 16-17

MJEKU POPULLOR
Ylli Merja: Si të luftoni infeksionet urinare duke përdorur bimët medicinale
Në faqen 12

PRANIMI NE UNIVERSITET
Matura Shtetërore ndryshon kriteret, Nikolla: Mesatarja duhet të jetë mbi 7
Në faqen 13

VENDIMET 2008-2017
Pronat që s'kanë marrë kompensimin, aplikimi për 3500 dosje e lista emërore
Në faqen 19

INTERVISTA NE "NEWS 24"


Admirali i SHBA: Dëbimi i diplomatëve rusë? Shqipëria, mesazh të fuqishëm
Në faqet 10-11

Raporti sekret i shefit të Shtëpisë Botuese “Naim Frashëri” për Reshpen, Polovinën...

Letra për Ramizin: Asnjëri s'iu kundërvu Gjergj Zhejit

Raporti i Fullanit: Si i spastruam poezitë moderniste të poetëve

Nga DASHNOR KALOÇI
Mënjëherë pas fjalimit të Enver Hoxhës më 15 dhe 16 mars të vitit 1973 në aparatën e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, ku si temë kryesore ishte: “Lufta kundër shfaqjeve të huaja dhe lib-



erale në art kulturë dhe ndikimi i tyre në të gjithë jetën e vendit”, ashtu siç kemi parë edhe në mjaft nga kapitujt e tjerë të këtij libri, në të gjitha institucionet kulturore dhe artistike të vendit, organizatat bazë dhe komitetet e partisë ...
Në faqet 14-15

RRUGA E KOMBIT MASAT

Lihen të lirë 10 prej protestuesve, 2 të tjerë në "Arrest shtëpie"

Dhuna në Rrugën e Kombit, gjykata lë në burg 11 prej të arrestuarve

Të akuzuarit: Policia na mori zvarrë në mes të natës

Ina Allkanjari


Në mjesditet e Gjykatës së Shkallës së Parë në Tiranë është zhvilluar ditën e djeshme seanca gjyqësore për 23 të arrestuarit e protestës së dhunshme në Rrugën e Kombit. Trupa gjyqësore ishte e kryesuar nga gjyqtarja e gjykatës së Kukësit, Alma Ahmeti. Në përfundim të seancës të arrestuarit u njohën me masën e sigurisë, ku u lanë në burg 11 nga 23 të arrestuarit. Ndërkohë, për 10 persona të tjerë është dhënë masa e sigurisë 'Detyrim paraqitje' dhe 'Arrest shtëpie' për 2 protestues të tjerë. Nëse të akuzuarit do të shpallen fajtor deri në përfundim të hetimit, sipas Kodit Penal ata rrezikojnë deri në 7 vite burg. Seanca për vlerësimin e masës së sigurisë zgjati rreth 5 orë dhe u shoqërua me momente tensioni të larta dhe konfrontim mes të afërmeve të të arrestuarve, opozitës dhe policisë. Protestuesit e ndaluar akuzohen për 'Dhunë ndaj forcave të policisë' dhe 'Shkatërrim të pronës'.



Të arrestuarit në gjykatën e Tiranës

AKUZA

Seanca për vlerësimin e masës së sigurisë zgjati rreth 5 orë dhe u shoqërua me momente tensioni të larta dhe konfrontim mes të afërmeve të të arrestuarve, opozitës dhe policisë. Protestuesit e ndaluar akuzohen për 'Dhunë ndaj forcave të policisë' dhe 'Shkatërrim të pronës'.



Efektive të policisë, dje paras gjykatës së Tiranës

11

PERSONA

Në përfundim të seancës të arrestuarit u njohën me masën e sigurisë, ku u lanë në burg 11 nga 23 të arrestuarit. Ndërkohë, për 10 persona të tjerë është dhënë masa e sigurisë 'Detyrim paraqitje' dhe 'Arrest shtëpie' për 2 protestues të tjerë.

'Blindohet' gjykata, në vendngjarje 1000 forca policie

Familjarët e të ndaluarve: Djemtë tanë protestuan se s'kanë të hanë

Protestat për lirinë e 23 të arrestuarve pas dhunës në Kukës për tarifën e Rrugës së Kombit, vijoi gjatë ditës së djeshme, teksa pritej masa e sigurisë për ta. Edhe pse forca të shumta policie u rreshtuan kordon përpara ambienteve të Gjykatës së Tiranës, dhjetëra qytetarë me pankarta dhe megafon protestuan nga ana tjetër e Lanës. Një kordon i Policisë së Rendit dhe Forcave Shqiptonja u vendosë rreth e rrotull Gjykatës për të parandaluar ndonjë përkrahje të tensioneve, duke pasur parasysh edhe protestën e zhvendosur në Tiranë përgjatë këtyre dy ditëve përpara Drejtorisë së Policisë. Plani i masave drejtohet nga drejtori i rendit dhe sigurisë Gjovalin Loka. Ndërkohë në vendngjarje



ndodhen 1000 forca policie. Protestuesit thërrisnin duke thënë se arrestimi i tyre është një turp. "Turp, turp, turp!" dhe "Lironi vëllezërit tanë", dëgjohej në protestuesit. Rrugën e Kombit të dyja krahet e Unazës është bllokuar komplet nga protestuesit, ndërkohë që kishin edhe mbështetjen e deputetëve të PD e LSI. Qarkullimi i automjeteve është bllokuar vetëm nga krahu i gjykatës. Një

qytetar, i cili duket se ka të afërm një prej të arrestuarve, që ka qenë pjesë e protestës në Rrugën e Kombit, nuk kurseu akuzat për qeverinë, ndërsa e cilëson atë si ajo e regjimit të egër komunist. Ndërkohë Servet Onuzi, babai i njërit prej personave të arrestuarit u bëri thirrje SHBA-ve që të ndryjë, që të 'qlirojë' Shqipërinë. "Djalin e kanë arrestuar në tre të natës. Policia erdhi me 5 furgona. Është një shtetërrim policor. Populli e ka bërë thirrjen e tij, s'ka çka të bëjë më. Donim të futeshim brenda, nuk na lanë. Tani na ka ngelur t'i bëjmë thirrje SHBA-ve, sikur e çliruan Gjermaninë, të çlirojnë edhe Shqipërinë. Pasi ai është një njeri (Rama) që e ka lënë Shqipërinë në shtetërrim, nuk dimë çfarë të bëjmë më", tha Onuzi.

vona të natës. "Erdhën na morën zvarrë në mes të natës, nuk na arrestuan në mëngjes", është shprehur njëri prej të arrestuarve përpara trupës gjyqësore. Mes të

SEANCA GJYQËSORE

Momente tensioni të larta kanë shoqëruar fillimin e seancës për caktimin e masave të sigurisë për 23 protestuesit e ndaluar, e cila u zhvillua në Gjykatën e Tiranës, për llogari të Gjykatës së Kukësit. Në nisje të seancës gjyqtarja e Kukësit, Alma Ahmeti kërkoi ndihmën e policisë për të zhvilluar një seancë me detyrë të mbyllura, gjë që solli pakënaqësi të deputetëve të opozitës dhe disa familjarëve, të cilët thyen derën e sallës ku mbahet seanca dhe u konfrontuan me policinë. Gjatë tentativave për të qenë pjesëmarrës në seancë, një nga familjarët

hipën mbi njerëzit e grumbulluar para derës së sallës së gjyqit, më qëllim që të futej brenda saj. Pas 45 minutash këmbëngulje nga deputetët opozitës, gjykata

vendosi t'i lejojë ata të ndjekin seancën gjyqësore. Ndërkohë gjatë seancës gjyqësore të akuzuarit janë shprehur se janë marrë me forcë nga policia në orët e

MASAT E SIGURISE

DETYRIM PARAQITJE

- Ahmet Tobli
- Lulëzim Popa
- Sajmir Trota
- Lefter Rexhmati
- Adem Duraku
- Armand Ademi
- Ardit Alidini
- Zenel Matmuja
- Fatos Harulla
- Rasim Koloshi

NË ARREST SHTËPIE

- Shaban Selmanaj

ARREST ME BURG

- Shpëtim Todaj
- Elton Cengu
- Florin Onuzi
- Shkëlqim Vata
- Xhevahir Gashi
- Ervis Oruçi
- Rasim Onuzi
- Vasil Laçi
- Hamdi Avziri
- Edmond Matmuja
- Xhevahir Hereni

arrestuarve është edhe Ahmet Tobi, një qytetar i sëmurë me zemër, ndërsa ka bërë dy koronare. "Jemi marrë nga krevati me pizhame. Nuk është e vërtete që jemi arrestuar ne orën 10 të mëngjesit, jemi arrestuar ne 3:00 të natës. Policië të maskuar na kanë marrë me forcë, ndaj prokuroria gënjen", tha një nga të pandehurit në sallën e gjyqit. Njëkohë që në orët e para të mëngjesit të djeshëm gjykata e Tiranës u blindua nga rreth 1 mijë forca policie, të cilët morën në ruajtje jo vetëm institucionin, por edhe gjithë bulevardin nga ura e drejtorisë së policisë

deri të kryqëzimi i Vasil Shantos. Në këtë zonë asnjë makinë nuk qarkullonte, madje edhe këmbësorët nuk janë lejuar. Këto masa sigurie u vunë në zbatim nga policia për të shmangur ndonjë reagim agresiv nga mbështetësit e të ndaluarve, të cilët prej disa ditësh protestuan para drejtorisë së policisë Tiranë dhe kishin paralajmëruar reagime nëse djemtë e tyre do të mbeshteshin në burg. Protestat për lirinë e të arrestuarve vijuan gjatë gjithë ditës së mërkurë, ku dhjetëra qytetarë me pankarta dhe megafon qëndruan nga ana tjetër e Lanës.



Faktet tronditëse, mes të arrestuarve të sëmure që qëndrojnë në karrocë me rrota

Përplasia, gjakoset Spaho: Policia na dhunoi, Rama s'do e ketë kollaj

Telefonata me Ruçin: S'ka ndodhur as në kohën e Enverit

Valentina Madani

Gjatë përplasjes para gjykatës, ku u dha masa e sigurisë për 23 protestuesit e arrestuar pas protestës së dhunshme në Rrugën e Kombit, mbeti i gjakosur dhe nënkryetari i PD, Edmond Spaho brenda gjykatës së Tiranës. Deputetët nuk janë lejuar të hyjnë brenda në sallën që do jepej vendimi për 23 të ndaluarit. Ata hasën përballjen me policinë që ka tentuar t'i nxjerrë jashtë duke u konfrontuar edhe fizikisht. Spaho është lënduar duke u gjakosur në fytyrë teksa tregoi para mediave gjakun edhe në këmishën e tij. Në një deklaratë për mediat ai paralajmëroi: "Jemi të gjithë kolegët aty, të kuptoni shtetin diktatorial të Edi Ramës. Policia nuk na lejoi të futeshim, ushtruan dhunë shikoni në çfarë gjendje jemi. Edi Rama ka për ta pasur shumë shpejt fundin, kështu me dhunë edhe si ka rrethuar gjysmën e Tiranës, nuk do e ketë kollaj, do përplasjet me qytetarët, do përplasjet me ne. Nuk na e del dot me dhunë". Ai nxori disa të dhëna, që i konsideron tronditëse. Sipas deputetit të PD-së, mes kuksianëve të arrestuar nga policia në mes të natës, ka njerëz të sëmure, madje persona që qëndrojnë në karrocë me rrota, madje ka nga ata që nuk kanë qenë fare në protestë. Pas incidentit brenda ambienteve të gjykatës së Tiranës, ku deputeti i PD-së mbeti i lënduar, pasi u konfrontuan me policinë, ai mori në telefon ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj. "Gjyqtarja deri tani nuk ka dhënë vendim. Kemi ardhur në kohën që nuk ishte marrë vendim. Na thanë do hyni dhe nuk na lejuan të hyjmë. Tani se si i kurdisni ju këto, që nuk lejoni deputetët, ky është turp i madh. Në nuk kemi ardhur këtu për të ushtruar dhunë, në kemi ardhur të ndjekim gjyqin, ju nuk na lejoni. Kjo nuk ka bërë vaki as në kohën e Enverit, që të rrihen deputetët. Të mora që ta zgjidh, je ministër i Brendshëm, ti mban përgjegjësi!" ka thënë Spaho në telefon. Po ashtu Spaho telefonoi edhe drejtorin e Policisë së Tiranës, Kastriot Skenderaj. Pas tensioneve



Nënkryetari i PD, Edmond Spaho

NORA MALAJ
Deputetja e LSI, Nora Malaj, u shpreh se forcat e policisë të armatosura kishin rrethuar sallën e gjykatës. "Pushteti i Ramës është i terrorizuar, dhe po ushtron presion edhe tek ligjvënësit. Policia të zbatojë rregullat ligjore që janë të barabarta për të gjithë. Të mos përshkallëzojë situatën.", tha Malaj.

DENONCIMI

Dy të rinj të Forumit Rinor të PD-së u shoqëruan me dhunë nga policia në Komisariatin numër 2 në Tiranë. Sipas PD-së, e cila denoncon ngjarjen, dy të rinjtë janë rrahur nga punonjësit e policisë. Për t'i ardhur në ndihmë, pranë Komisarariatit numër 2, ka mbërritur edhe nga autoambulancë. Mësohet se dy të rinjtë e FRPD të arrestuar janë shtetasit Gentjan Gjonaj dhe Ardit Zeneli.

"Heroi që po i bën gjyqin Ramës"

Berisha: Tani radhën e ka revolta e përgjithshme popullor

Ish-kryeministri Sali Berisha bëri dje thirrje për revoltë të përgjithshme popullore, pas vendimit të gjykatës së Kukësit për protestuesit, 11 prej të cilëve u lanë në burg. Berisha thotë se ky është një vendim politik hakmarrës dhe i bazuar në falsifikime. "Vendim politik hakmarrës dhe antikushnetues! Farsa gjyqësore politike më e turpshme, që nga kohërat më të zeza në diktaturë. Vendimi i turpshëm i bazuar kryekëput në falsifikime kriminale të dosjeve e procesverbalet dhe pa asnjë provë e asnjë fakt dhënë me urdhër të kryegjykatësit, kryetrafikantit Edvin Kristaq Rama dhe që e lexoi në sallën e gjyqit përfaqësuesja e tij. Ky vendim që lë në burg dhe arrest shtëpie shumicën e protes-



Ish-kryeministri Sali Berisha

tuesve të pafajshëm, është një thirrje për çdo shqiptar, të përmbysim sa më parë këtë klikë të urryer nga mbarë shqiptarët! Tani radhën e ka revolta e përgjithshme popullore!", shkruan Berisha. Ish-kryeministri postoi një video në Facebook-un e tij ku duken momente nga salla gjyqësore ku u dha masa për 23 të arrestuarit pas protestës së dhunshme në Kukësi për

tarifën e Rrugës së Kombit. Në video duket një qytetar i Kukësit, i cili shprehet i revoltuar për taksën e rrugës, por edhe për arrestimin e protestuesve. "Lulzim Popa, një hero në sallën e gjyqit, një baba me katër fëmijë i bën gjyqin Edvin Kristaq Ramës dhe narkoregimit të tij! Sb," shkruan Sali Berisha.



Konfrontimet në gjykatë, Arben Ristani: Rrethuan gjysmën e Tiranës

Sekretari i Përgjithshëm i PD-së, Arben Ristani, dha dje detaje nga konfrontimi fizik me policinë brenda ambienteve të gjykatës së Tiranës, ku jepej masa e sigurisë për 23 të arrestuarit pas protestës së dhunshme në Kukës. Ristani tha se në sallën e gjyqit nuk janë lejuar të futen as familjarët dhe as deputetët e opozitës, PD dhe LSI. "Gjysma e Tiranës është e rrethuar me trupa policore. Një grup deputetësh të PD dhe LSI erdhën të ndjekin gjyqin, kur tentuan të futemi aty, policia filloi të na shtynte për të na nxjerrë jashtë. Kjo ndodhi në mënyrë të paligjshme, policia gjakosi deputetin Edmond Spaho. Familjarët nuk u lejuan të futen, por as deputetët që duan të ndjekin një seancë gjyqësore në këtë Shqipëri, që nuk e di ka mbetur ndonjë fije demokracie," tha Ristani. Më herët ishte dhe kreu i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, Edmond Spaho, i cili i gjakosur akuzoi policinë se kishte ushtruar dhunë ndaj tyre.

të krijuara te gjykata e Tiranës, ku deputetët e PD-LSI u përplasën me policinë, Lulzim Basha u bëri thirrje të gjithë socialistëve të marrin në dorë situatën. Duke sulmuar kryeministrin Edi Rama, kreu i PD iu ka kërkuar socialistëve të ndalin aventurierin e çmendur që po e çon vendin drejt një spiraleje dhune për interesat e pasurisë dhe pushtetit të tij e të kriminelëve që e

rrethojnë. Basha publikoi në Facebook një video nga përplasia te gjykata, duke dalë në krah të qytetarëve. "Akti i fundit i degradimit të çdo pushteti është kur kthehen kundër popullit të tyre. Sot të gjithë po kuptojnë një regjim që mbështetet mbi drogën dhe krimin prodhon dhunë dhe përplasje. Siç e pa çdo shqiptar para pak ditësh, Edi Rama ka hum-

bur çdo kontroll nën efektin e substancave që merr. Prandaj ju bëj thirrje të gjithë shqiptarëve dhe atyre deputetëve të ndershëm socialistë, që të marrin situatën në dorë dhe të mos lejojnë një aventurier të droguar që ka humbur kontrollin të krijojë përplasje me njerëzit dhe ta çojë vendin drejt një spiraleje dhune për interesat e pasurisë dhe pushtetit të tij e të kriminelëve që e rre-

Shtjete me Ankaned të pare nga Studio Permbarrimore L.D.C
- Apartament" me nr. pasurisë 1/1309-1-19, vol. 37, faqe 217, ZK. 8532, regjistruar në Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier. Me çmim shtjete 36.000 Euro
Data e shpalljes 15.03.2018
Data e zhvillimit 11.04.2018 deri në orën 16.00
Ankandi zhvillohet në ambientet e zyrës Studio Permbarrimore L.D.C të ndodhur në adresën: Rruga "Myslym Shyri", Vila 8/1, Kati 1, Tiranë, e-mail: erjon.papalazzo@yahoo.com

PROTESTA PER TAKSEN REAGIMET

"Thirri, thirri të të ngrihet", 9 deputetë: Masa më e rëndë për kryeministrin

LSI, kërkesë Ruçit: Përjashto Edi Ramën nga seancat, foli si rrugaç

Kryemadhi: Fjala e politikës mbaroi, radha e popullit

LSI i kërkoi dje kryetarit të Kuvendit, Gramoz Ruçi përjashtimin e kryeministrit Edi Rama nga punimet e seancave të Kuvendit. Përmes një kërkesë zyrtare, firmosur nga nëntë deputetë të LSI-së, kjo parti i kujton Ruçit fjalorin e përdorur nga Rama në seancën e 29 marsit. "Grupi parlamentar i partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, duke marrë shkas nga sjellja në kundërshtim me rregulloren e Kuvendit të kryeministrit Edi Rama, i cili në seancën plenare të Kuvendit të datës 29.03.2018, me një gjuhë prej rrugaçi përdori fjalorin fytes, përcjemes dhe poshtëruës ndaj deputetëve të Kuvendit, qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, ju drejtohet me këtë kërkesë për marrjen e masës disiplinore për përjashtimin e tij nga zhvillimet e punimeve të Kuvendit", thuhet në këtë kërkesë të LSI-së. Rama në këtë seancë ka thënë sipas kërkesës së LSI-së: "Nuk mund dot ju të bllokoni asgjë dhe të pengoni asgjë dhe për më tepër pastaj, jo po... shiko këtu se do ngrihen këta, do ngrihen ata, kjo e ngritjes është 'Thirri, thirri të të ngrihet, ai i shkreti kokulur, s'të përgjigjet dot'. Në kërkesën e saj, LSI vijon: "Nuk është hera e parë që përmes retorikës së vet si në rastin e mësipërm, kryeministri Edi Rama u drejtohet deputetëve dhe qytetarëve me shprehje apo stilema të tilla fyese dhe denigruese, që dëshmon se kemi të bëjmë jo vetëm me rase të përsëritura, por edhe me një konsistencë të shfaqjes arrogante e me mungesë të etikës dhe të normave më elementare të edukatës nga ana e tij, çka përbën një shkelje flagrante të rregullores së Kuvendit dhe të normave të etikës parlamentare dhe qytetare në komunikimin publik". Sipas LSI-së, "krahësimi që kryeministri Edi Rama u bën deputetëve dhe qytetarëve shqiptarë me organin genital mashkullor është rast i paprecedent dhe shfaqja më e shëmtuar e qëndrimit të tij ndaj popullit". Deputetët e LSI-së kërkojnë që ndaj Ramës të merret masa më e rëndë e parashikuar në nenin 65 të rregullores së Kuvendit.



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

PETRIT VASILI

"Kryeministri, një kufomë politike në kalbëzim e ka vendin në kosh të plehrave", u shpreh dje kreu i grupit parlamentar të LSI-së. "Tani çdo qytetar e ka shumë të qartë që ka për kryeministër një ordiner dhe të paburrë, që fshihet pas brekëve të policisë", tha Vasili, ndërsa deputetë e qytetarë ishin në dyert e gjykatës.

Mazhoranca mbledh pa opozitën komisionin hetimor

"Tahiri", Felaj: Të dëshmojnë Berisha, Basha. Paloka: Mbledhja, shkelje e ligjit

Mazhoranca thirri dje komisionin hetimor parlamentar "Tahiri" në mungesë të deputetëve të opozitës, të cilët ishin në Gjykatën e Tiranës, në mbështetje të 23 protestuesve të Rrugës së Kombit. Edhe pse ky komision drejtohet nga demokrati Edi Paloka, ai nuk ishte i pranishëm. Deputetja Ermonele Felaj sqaroi se mbledhja nuk u thirr me urgjencë, pasi ishte përcaktuar të mbledhej qysh në datën 26 mars. "Fatkeqësisht, opozita nuk ka një axhendë të lidhur me interesat e vendit, por qartësisht me interesat e kolltukut! Sidoqoftë, ne jemi të vendosur të bëjmë atë çfarë na mundëson ligji për t'iu treguar shqiptarëve se edhe trafikun e drogës e ngriti në sistem, e ligjëroi hapur apo fshehtas



pagërgjegjshmëria e tyre në qeverisjen e vendit", tha dje Felaj. Ajo ka përmendur disa nga çështjet më të bujshme në vend, për të cilat PS do t'i drejtohet Shërbimit Informativ Shtetëror për të kërkuar informacion lidhur me trafikun e drogës. Felaj tha se do të kërkojë informacion nga

Ndërkaq më herët, kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi u shpreh për mediat: "Hakmarrja primitive e Edi Ramës u pasqyrua sot (dje) në vendimin e gjykatës, krejtësisht arbitrare dhe në shkelje të hapur të ligjeve dhe Kushtetutës së vendit. Kryeministri humbi

sot (dje) përballjen e tij me të vërtetën dhe shtetin e së drejtës. Ai dhe veglat e tij në prokurori dhe gjykatë po sot (dje) dëshmuuan se drejtësia vdiq". Pas mbështetjes që deputetë të opozitës u dhanë protestuesve që morën masën në Gjykatën e Tiranës, Kryema-

dhi tha: "Tashmë me këtë pushtet nuk ka asnjë bashkëpunim civil. Ky vend është në duart e një kryeministri hajdut, të papërgjegjshëm dhe peng të bandave dhe kriminale. Edi Ramën nuk mund ta shpëtojë dot askush nga revolta e popullit. Kushdo qof-



Deputeti

PJERIN NDRU

Deputeti socialist, Pjerin Ndreu, e konsideroi të ligjshme protestën e kuksianëve për taksën e Rrugës së Kombit, por nuk duhen përdorur nga matrapazet. "Kam mbështet dhe do mbështes çdo kuksian që proteston për taksën e lartë, sepse ka të drejtë. Por qeveria po merret seriozisht me evidentimin e atyre qytetarëve, që janë përdorues të shpeshtë të rrugës që të kenë tarifa të ulëta", tha Ndreu.

Taksa e rrugës, Meta pret Limajn: Çdo vendim të jetë i konsultuar

Presidenti Ilir Meta priti dje në një takim zv.kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi. Temë diskutimi mes tyre ka qenë edhe Rrugja e Kombit. Sipas njoftimit të Presidencës, mes Metës dhe Limajt është ndarë bindja se Rrugja e Kombit është investimi më madhor që kanë bërë dy vendet tona e që ka ndihmuar ndjeshëm rritjen e shkëmbimeve të gjithanshme midis dy vendeve dhe qytetarëve tanë. Por, shpreh rezervë për tarifën në këtë rrugë. "Ndamë të njëjtën bindje se Rrugja e Kombit është investimi më madhor që kanë bërë dy vendet tona, e cila ka ndihmuar ndjeshëm rritjen e shkëmbimeve të gjithanshme midis dy vendeve dhe qytetarëve tanë", u shpreh Meta në rrjetin social 'FB'. "Mirëmbajtja dhe rritja e standardeve të lëvizjes dhe sigurisë është shumë e rëndësishme, por çdo vendim në këtë drejtim duhet të jetë i mirëstudiuar dhe i konsultuar, në mënyrë që ky korridor kombëtar jetik të gjenerojë edhe më shumë zhvillim dhe mirëqenie për qytetarët tanë. Mirëmbajtja dhe rritja e standardeve të lëvizjes dhe sigurisë është shumë e rëndësishme, por çdo vendim në këtë drejtim duhet të jetë i mirëstudiuar dhe i konsultuar, në mënyrë që ky korridor kombëtar jetik të gjenerojë edhe më shumë zhvillim dhe mirëqenie për qytetarët tanë", thuhet në deklaratën e shpërndarë nga Presidenti Meta.



shin këta, të cilët pasurohen çdo ditë me gjakun e shqiptarëve që varfërohen çdo ditë e më shumë. Frika nga populli po ia merr frymën, por ky frikacak nuk mund ta mbysë një popull të tërë. Vepërimet e opozitës janë legjitime tashmë në krye të popullit, që

nuk pajtohet me dhunën policore dhe kriminale të Edi Ramës. Ata policë që i shërbejnë pushtetit duhet të llogarësin edhe fundin e karrierës së tyre bashkë me pushtetin e Edi Ramës. Sot fjala e politikës mbaroi. Tani fjalën e ka populli", tha Kryemadhi.

Opozita sot bllokoi rrugët, i kërkon Ruçit shtyrjen e seancës së Kuvendit

Basha: Nisim mosbindjen civile, pikat strategjike që bllokojmë

"Fundi i Ramës, do jemi pranë qytetarëve"

Valentina Madani

Opozita nis sot mos bindjen civile dhe si akt i parë është parashikuara bllokimi i akseve rrugore. Nga ora 10:00-13:00 pothuajse i gjithë qarkullimi në Shqipëri do të jetë i paralizuar, kjo pasi 4 akset kryesore do të bllokohen me protestues. Qytetarë të mbështetur edhe nga PD do të bllokojnë kryqëzimin e Milotit, i cili lidh Tiranën me Shkodrën, por edhe Rrugën e Kombit me Tiranën dhe Durrësin. Gjithashtu, do të bllokohet kryqëzimi i Çermës në Lushnjë që bllokoi lëvizjen në jug të vendit, kryqëzimin e Vorës dhe kryqëzimi i Bradasheshit në Elbasan. Në funksion të kësaj proteste opozita kërkoi që seanca e parashikuar në orën 10:00 të shtyhet në orën 18:00. Demokratët propozojnë që Kuvendi të mblidhet në orën 18:00, pasi të jetë zhvilluar protesta e opozitës, ku do të bllokohen disa akse rrugore nacionale. Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, zbuloi dje pikat strategjike që do të bllokohen ditën e nesërme nga opozita, e cila do të ngrihet në protestë kundër taksës në Rrugën e Kombit.

Opozita iu bërë thirrje qytetarëve të bashkohen dhe të dalin në rrugë kundër qeverisë Rama. "Do jemi në protestat e njoftuara nga qytetarët, sipërmarësit e vegjël, fermerët, njerëzit që janë larguar nga ndihma ekonomike, në Bradashesh, Vorë, Milot. Do jemi në krah të tyre, një popull i bashkuar do të rezistojë. Kjo diktaturë dhe tirania e krimit i ka orët e numëruara. Socialistët e ndershëm ta refuzojnë këtë bandë në pushtet. I thërras të gjithë të bashkohemi", tha z.Basha. Gjithashtu, Basha hodhi akuzat të forta ndaj Ramës pas vendimit të gjykatës për të lënë në burg 11 prej protestuesve të arrestuar në Rrugën e Kombit, duke thënë se kryeministri ka privatizuar policinë, prokurorinë dhe gjykatat. "Rama ka privatizuar policinë, gjykatat, prokurorinë. Ky është regjimi që shkel e nëpërkëmb liritë dhe të drejtat e qytetarëve. Gjykatat, prokuroria, policia kanë shkelur të drejtat e qytetarëve të pafajshëm. Lulzim Popa, invalid, u grabit në mes të natës dhe mbajti pa ilaçe. U ngrit se nuk kishte para të paguante traun që i vuri të dera e shtëpisë. Ai burgos qytetarët dhe të



BLLOKIMI

Qytetarë të mbështetur edhe nga PD do të bllokojnë sot kryqëzimin e Milotit, i cili lidh Tiranën me Shkodrën, por edhe Rrugën e Kombit me Tiranën dhe Durrësin. Gjithashtu, do të bllokohet kryqëzimi i Çermës në Lushnjë që bllokoi lëvizjen në jug të vendit, kryqëzimin e Vorës dhe kryqëzimin e Bradasheshit në Elbasan.

DEKLARATAT



TAKIMI

Kreu i PD-së, Basha dhe kryetarja e LSI, takuan dje Eurodeputetin Fleckenstein dhe ambasadorin e BE, Vlahutin. Takimi vjen pas thirrjeve të opozitës për mosbindje civile, e njoftuar të nisë sot në orën 10:00.



MBLEDHJA

Kryetari i PD në Shkodër, Ramiz Çobaj paralajmëroi bllokim të rrugëve dhe mospagim të tarifës. "Shkodra u përmbyt, familjeve iu hoq ndihma ekonomike, biznesi i vogël po falimenton nga taksat e vendosur".



DEKLARATA

"Rama si serbët! Pasi tenton ta ndajë kombin për 10 euro, sillat edhe më keq se pushtues me arrestet e qytetarëve. Njësoj si Serbia që i arrestonte në Prishtinë dhe i mbante në burg në Beograd! - tha Saliani.



"Ose duhet shporrur, ose do të jetë më keq"

Bylykbashi: Ramistani, kandidat për në Bashkimin e Azisë Qendrore

Oerd Bylykbashi, deputet i PD-së, përmes një komenti në rrjetet sociale shkruan se Ramistani, është shtet kandidat për në Bashkimin e Azisë Qendrore. Referuar asaj që ndodhi dje në gjykatën e Tiranës ku u caktuan masat e sigurisë për 23 qytetarë të Kukësit, Bylykbashi shkruan: "Nëse gjykatat kanë rënë de facto, në tokë apo nën thundër, askush nuk e garanton zbatimin e Kodit të Procedurës Penale, pra shtetasi nuk ka de facto asnjë mbrojtje ndaj arbitraritetit të shtetit?". Demokracia është procedurë". "Nuk e them unë, por është postulat. Kjo e bën shtet të së drejtës një demokraci, përndryshe është thjesht pushtet i shumicës mbi pakicën, e këtë nuk e ndan shumë distancë nga dhuna e shumicës. Ky është



të Ramistani që u krijua falë Rrumpallës në Drejtësi. Kryeministri Rama si një autokrat, parlamenti si një shtupë e rrecoosur në dorën e tij dhe gjykatat të rrënuara e që nuk guxojnë t'i

"Nëse gjykatat kanë rënë de facto, në tokë apo nën thundër, askush nuk e garanton zbatimin e Kodit të Procedurës Penale, pra shtetasi nuk ka de facto asnjë mbrojtje ndaj arbitraritetit të shtetit?". Demokracia është procedurë"

kundërvihen e ta ndalin këtë autokrat. Ky Ramistan duhet shporrur nga të gjithë ata që i thonë vetes qytetarë, ose do të shihni akoma më keq!,- shprehet z.Bylykbashi.

libër Tahirin. Sejdini që me bandën e tij terrorizojnë një qytet të tërë. I lirë Arben Ahmetaj që iu merr qytetarëve milionat me inceneratorët. Rama ka privatizuar policinë që sot bëri shtetretim në Tiranë. Ka privatizuar gjykatën, që sot dhunojnë deputetët e opozitës, sepse nuk donte që shqiptarët të dëgjonin dëshmitë tronditëse të kukijsaneve të pafajshëm, që protestuan për bukën e gojës. Regjimet, të cilat i kundërvihen interesit pub-

lik, janë vetëm hapa para rrëzimit. Popullin shqiptar nuk e rrëzon dot, ne do jemi në krah të tyre", theksoi z.Basha. Më herët Basha u shpreh në 'facebook' se shqiptarët po shohin fytyrën e vërtetë të shtetit kriminal të Edi Ramës. Lidhur me këtë, Basha fajësoi kryeministrin Edi Rama, mbron kriminelët e mafian, duke paralajmëruar se beteja sapo ka filluar. Sipas tij, shqiptarët po kuptojnë se policia, prokuroria dhe drejtësia politike janë në

duart e grupit kriminal që ka kapur të gjitha pushtetet në vend. "Shqiptarët po shohin fytyrën e vërtetë të shtetit kriminal të Edi Ramës. Shqiptarët po kuptojnë se policia, prokuroria dhe drejtësia politike janë në duart e grupit kriminal që ka kapur të gjitha pushtetet në vend. Sot shqiptarët po shohin fytyrën e vërtetë të drejtësisë së Edi Ramës: kriminelët dhe mafia mbrohet, kurse populli trajtohet sikur të ishte kriminel", deklaroi z.Basha.



Boçi për Ramën: 'Dhjaksi' ka shumë etje për pushtet

Deputeti i PD Luçiano Boçi në një reagim në rrjetet sociale për situatën e krijuar këto ditë, pas arrestimit të 23 protestuesve në Kukës, që u tubuan të shtunën në Tunelin e Kalimashit, përdor shprehjen "dhjaksi" për të ofenduar kryeministrin Edi Rama. Sipas tij, tmerr i që pushton e shtyn gjithnjë e më shumë drejt harbutërisë të pushtetit që i jepet. "Dhjaksi nuk ka turp. Sepse ka vetëm frikë. Shajpe nuk i bën përshlytje. Foll seriozisht ai qesh. Vetëm kur ndjen kërcënimin humb çdo arsye. Dhjaksi është gjithmonë arrogant. Tmerr i që pushton e shtyn gjithnjë e më shumë drejt harbutërisë të pushtetit që i jepet. Dhjaksi i ka të domosdoshëm aksesoret. Është i paplotësuar, prandaj i duhet një vizë "të ndjehet guximtar". I duhet kostum me atlete të ndjehet i veçantë, për të bërë përshlytje, për t'u dukur. Dhjaksi nuk as atdhe, as familje, as të ardhme. Ka vetëm veten e tij dhe është i lidhur përjetësisht me frikën e tij. Dhjaksi është njeriu më i pavlerë. Largimi i Dhjaksit nga pushteti i tij i frikës, është detyrë qytetare", -tha z. Boçi.

RRUGA E KOMBIT TAKSAT

Ministri i Financave: Taksa e qarkullimit nuk ndryshon, përdoret për qëllime të tjera

Taksa për Kukësin, Ahmetaj: Grupet që "amnistohen"

Dy javë negociata për përgjysmimin e tarifave për kuksianët

Ornela Manjani

Ministri i Financave dhe Ekonomisë Arben Ahmetaj tha dje se po zhvillohen negociatat, të cilat do të mbylljen brenda një muaji e ku synimi është që të realizohet përjashtimi për ata që e përdorin rrugën "për të hyrë e për të dalë në shtëpi". Po ashtu, për mjetet e transportit publik të zonës, Ahmetaj tha se po negociohet për reduktim të tarifës. Gjatë raportimit në Komisionin e Ekonomisë Ministri Ahmetaj theksoi se "kontrata, në logjikën e saj, i referohet negociatës pasi të dalin statistikat. Kryeministri ka kërkuar që kjo negociatë të bëhet përpara se të dalin statistikat për të përfshirë si një paketë sociale solidariteti. Opozita nuk ishte e pranishme në raportimin në komision të ministrit Ahmetaj, ndërkohë që kryetari Erion Braçe kërkoi pikërisht që të ketë lehtësira për banorët që preken nga vendosja e tarifave për kalimin në Rrugën e Kombit. "Një kategori e caktuar, qoftë përdoruesish atje, qytetarë, banorë të zonës, duhet të përjashtohen nga pagesa e asaj tarife. Do të doja të dija, nëse ju po i mëshoni kësaj pike në negociatat që ju po bëni me koncesionarin", tha Braçe. "Kontrata që do ndryshojë i referohet një procedurë shumë të detajuar, rigorozë ligjore që kalon në një sërë filtrash. Ato që ju keni shqetësime janë në tryezën e negociatës", tha ministri Ahmetaj. Në negociatën me koncesionarin po bisedohet edhe në lidhje me reduktimin e tarifimit për mjetet e transportit të qytetarëve.



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj, dhe një anëtar i Komisionit të Ekonomisë

NEGOCIATAT

"Kontrata që do ndryshojë i referohet një procedurë shumë të detajuar, rigorozë ligjore që kalon në një sërë filtrash. Ato që ju keni shqetësime janë në tryezën e negociatës", - tha ministri Ahmetaj. Në negociatën me koncesionarin po bisedohet edhe në lidhje me reduktimin e tarifimit për mjetet e transportit të qytetarëve.

Analiza e gjashtëmuorit

Ahmetaj: Taksa re e ndërtesës ka sjellë ulje në të gjithë sektorët

Taksa e re e ndërtesës ka sjellë ulje në të gjithë sektorët. Kështu është shprehur ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj në analizën e gjashtëmuorit të parë të mandatit, përpara Grupit Parlamentar Socialist. "Taksa e ndërtesës ka sjellë ulje për kategorinë e prodhimit, sektorin e bujqësisë. Kemi përjashtuar të gjithë pensionistët. Kemi përjashtuar shtëpitë e para '93-it." Sipas Ahmetajt, viti 2017 është edhe viti me rritjen më të lartë ekonomike, e cila është shoqëruar me elementë të rritjes si ajo e fuqisë blerëse. Arsyetja sipas ministrit lidhet me përmirësimin e tregut të punës, duke e konsideru-



ar pjesëmarrjen në forcat e punës me një rritje të konsiderueshme. "Janë krijuar rreth 37-38% e totalit të vendeve të punës. Mbi 220 mijë vende pune të krijuara që nga viti 2013." Më tej, Ah-

metaj është shprehur se ka pasur një rritje të madhe ekonomike, pavarësisht me gjithë vështirësitë e prodhimit të energjisë në vitin 2017, që sipas tij dëmtoi seriozisht ekonominë. "Referuar QKB-së, në 2017 kemi neto 14 mijë biznese të reja. Janë hapur 19 mijë dhe janë mbyllur 5 mijë. Të regjistruara në 2017, biznese të reja janë 1292 biznese të reja. Janë biznese të reja neto në janar shkurt 2248 biznese të reja", tha ministrit. Lidhur me borxhin publik, Ahmetaj ka deklaruar se ai është ulur me 13.7% dhe do të vazhdojë të ulet, duke shtuar se qeveria Rama nuk ka krijuar një borxh të ri.

kutimi mbi taksën e Rrugës së Kombit në Komisionin e Ekonomisë ka nisur pa praninë e opozitës. "Taksa e qarkullimit nuk shkon në destinacionin e përdorimit. Shkon për ndërtim rrugësh, shlyerjen e borxhit të trashëgaur, për financimin e shëndetësisë dhe ndihmës ekonomike", - tha ministri. Ai tha se rruga është e pa-

përfunduar dhe se duhen edhe 200 milionë euro për mbylljen totale të saj. Në segmentin e dytë mungojnë masa mbrojtëse. Në segmentin e tretë mungojnë urat. Sipas ministrit Ahmetaj, gjeneza e kontratës koncesionare fillon me VKM 874, në 2011 për përcaktimin e autoritetit kontraktues për mirëmbajtjen dhe operimin

e autostradës Milot-Morinë. Për transparencë, procesi ka filluar që në 2011. Ahmetaj tha se konsulenti paraqiti tre skenarë, për kryerjen e investimeve në rrugë. Kontrata është bërë efektive më 9 shtator 2017 dhe është firmosur nga ministri Sokol Dervishaj. Kontrata bazohet në skenarin 1 të IFC. 5.3 dhe 5.9 euro për



RRUGA MILOT-MORINË

■ BRAÇE PESË PROPOZIME PËR QEVERINË

Kreu i Komisionit të Ekonomisë Erjon Braçe i ka paraqitur dje qeverisë përmes ministrit të Ekonomisë dhe Financave Arben Ahmetaj pesë kërkesa në lidhje me grupet që duhet të përjashtohen nga taksa e përdorimit të rrugës Milot-Morinë.

"Në Komisionin për Ekonominë dhe Financat në Kuvend, unë dhe kolegët e mi deputetë, kërkuam nga ministri i Financave e Ekonomisë dhe qeveria:

- 1- Përjashtimin nga pagesa e Tarifës së Përdorimit të rrugës Milot-Morinë të, banorëve të zonës rreth autostradës në Kukës që, për nevojë të shkuarjes në shtëpitë e tyre apo të përdorimit të pronave të tyre, ju duhet të hyjnë e të lëvizin në autostradë.
- 2- Përjashtimin nga pagesa e Tarifës së Përdorimit të rrugës Milot-Morinë të, autobusëve dhe mjeteve të tjera që kryejnë transportin publik të banorëve të zonës duke lëvizur në autostradë.
- 3- Mundësinë e përjashtimit nga pagesa e Tarifës së Përdorimit të rrugës për, mjetet që përdoren nga shtetas që janë para e tetraplegjike.
- 4- Adresimin e qartë dhe konkret të fondit të kompensimit tek autoritete të besueshme, me qëllim përdorimin e këtij fondi vetëm për njerëz që preken nga vendosja e Tarifës së Përdorimit të rrugës.
- 5- Auditimin e plotë të ndërtimit të rrugës Rrëshen-Kalimash-Morinë, posaçërisht auditimin e dëmit të shkaktuar në vitin 2009 në tunelin e Thirrës, hapur para kohe për nevojë politike, informimin e komisionit rreth këtij auditimi dhe kallëzimin e çdo përgjegjësi për dëmin e rezultuar"-shkruan Braçe në 'FB'.

TAKSA E QARKULLIMIT

Taksa e qarkullimit, që vilet aktualisht në shtitjen me pakicë të naftës në nivelin 32 lekë për litër me gjithë TVSH, nuk do të ndryshojë edhe pas vënies së taksës në Rrugën e Kombit, - tha në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë, ministri i Financave, Arben Ahmetaj. Dis-

një makinë pa TVSH, qeveria jonë arriti një marrëveshje 5.5 euro me TVSH. "E kemi të domosdoshme të kthehemi në historik të rrugës. Ajo rrugë është e papërfunduar dhe ka kushtuar 1.3 miliardë dollarë. Nga të cilat 300 milionë janë të vjedhura, ku Lulzim Basha ishte kryesor i -tha ministri. Të ardhurat nga projekti,

përlllogaritjet janë mesatare, 12.6 milionë, teksa dyshemeja vjetore e të ardhurave nga koncesionari është 9.4 milionë euro. Qeveria do të plotësojë shumë nën 9.4 milionë euro që mungon nga trafiku i garantuar. Ministri i Financave tha se të ardhurat në buxhet nga kontrata e koncesionit do të jenë 71 mln euro.



Ministri i Infrastrukturës së Kosovës, Pal Lekaj gjatë ditës së djeshme ka zhvilluar një takim me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, me të cilin kanë diskutuar për taksën në Rrugën e Kombit. Lekaj e ka ritheksuar se taksa është e lartë dhe se institucionet kosovare nuk pajtohen me këtë çmim, shkruan IndeksOnline. "Në takim me ambasadorin Qemal Minxhozi diskutuam zhvillimet e fundit në dy vendet tona, me theks të veçantë për çështjen e taksës rrugore për të cilën e ritheksova papajtueshmërinë tonë me çmimin dhe mënyrën se si është marrë ky vendim për një rrugë nga arteriet kryesore të lidhjes ndërrshqiptare, që është Rruga e Kombit. Po ashtu e diskutuam edhe letrën zyrtare me të cilën i jemi drejtuar Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjetikës, z. Damian Gjoknuri dhe për mungesën e përgjigjes në këtë letër. Ishte dakordim i dyanshëm që hapat e mëtejshëm të bëhen me dakordancë të plotë. Shqipërisë dhe Kosovës si dy vende vëllezërore ju duhen marrëdhënie me influencë pozitive për zhvillimin e gjithëmbarshtëm", ka thënë ndër të

Ministri kosovar, takim me ambasadorin e Shqipërisë

Kosova kundër taksës në Rrugën e Kombit, Lekaj: S'e pranojmë tarifën dhe si u mor vendimi



tjera ministri i Infrastrukturës së Kosovës, Lekaj. Ndërkohë që më parë, qytetarët e Kosovës nuk e kanë mirëpritur aspak vendimin e qeverisë shqiptare për vendosjen e një takse në Rrugën e Kombit. Sipas tyre, tarifata janë të larta dhe taksa e vendosur do të ndikojë në uljen e qarkullimit të njerëzve dhe mjeteve drejt Shqipërisë. "Po

një taksë ka qenë e nevojshme për atë rrugë, sepse është shpenzuar shumë, mirëpo jo aq takse e madhe, 5 euro andej e 5 këndej, 10 euro. Pensionisti e mendon, sikur unë dhe ky kolegu, të shkojmë, i harxhoj 10 euro benzinë, 10 euro duke shkuar dhe 10 duke u kthyer, kështu nuk po shkoj hiç. Ata e kanë pakuar numrin e qarkullimit të mjeteve me këtë farë forme të pagesës", thotë një qytetar. Taksa për çdo vajtje-ardhje prek edhe bizneset e Kosovës, të cilat detyrohen të paguajnë vlerën prej 10 eurosh sa herë që kalojnë në Rrugën e Kombit.

Konsulenca e BE-së: Shqipëria mbledh më shumë të ardhura sesa shpenzon

Të ardhurat nga taksa, më shumë se kostoja për mirëmbajtjen e rrugëve

Kostoja për rrugët 2015-2019 arrin në 329 milionë euro

Qeveria shqiptare ka një zbatim një strategji për mirëmbajtjen e rrugëve 2015-2019, sipas të cilës kostoja arrin në 329 milionë euro, ose 65.8 milionë euro në vit. Komisioni Europian nëpërmjet programit IPA dhe kompanisë TIEG, që ka dhënë konsulentë teknike për planin e mirëmbajtjes që po zbaton qeveria në studimin e saj konstaton se buxheti i alokuar për mirëmbajtjen e rrugëve në Shqipëri është rreth 25% -30% e buxhetit total të nevojshëm për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore (rreth 329 milionë euro për periudhën 2015-2019). Raporti është hartuar në vitin 2016. Kompania konsulente thotë se "shpenzimet aktuale buxhetore për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor kombëtar janë më të ulëta se, pagesat e përdoruesve të mbledhura (taksat e akcizës së karburantit, taksat e karburantit të qarkullimit". Konsulenti thotë se, qeveria shqiptare mbledh taksa për qarkullimin më shumë se nevojat për mirëmbajtjen e rrugëve. Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit në Shqipëri ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare. Po krijimi i parakushteve për integrimin në BE thotë Konsulenti kërkon zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë. Kështu rritja e aksesit të mallrave dhe pasagjerëve në tregti dhe ofrimin e shërbimeve kontribuon dukshëm në rritjen e përgjithshme ekonomike dhe zhvillimin në ekonomi.



VLERËSIMI
Komisioni Europian nëpërmjet programit IPA dhe kompanisë TIEG, që ka dhënë konsulentë teknike për planin e mirëmbajtjes që po zbaton qeveria në studimin e saj konstaton se buxheti i alokuar për mirëmbajtjen e rrugëve në Shqipëri është rreth 25% -30% e buxhetit total të nevojshëm për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore (rreth 329 milionë euro për periudhën 2015-2019).


Konsulenti vlerëson se prioritet strategjik është përshejtimi i integritetit të sistemit të transportit në Shqipëri dhe krijimi i një tregu të integruar, i cili përbëhet nga infrastruktura e transportit nga toka (rruga dhe hekurudha), nga deti dhe nga rrugët ujore. Qëllimi kryesor i zhvillimit të sektorit për periudhën 2015-

2020 parashihet të jetë "zhvillimi i një sistemi efikas të transportit, i integruar në rajon dhe në rrjetin e BE, i cili promovon zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së qytetarëve". Përkundër investimeve të rëndësishme sidomos në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, sektori i transportit ende nuk është bërë një promotor i

rëndësishëm i zhvillimit ekonomik në Shqipëri, thotë studiimi. Financimi në kohë dhe adekuat i investimeve të programit vjetor dhe afatmesëm mbetet problematik, vëren konsulenti. Për më tepër, cilësia e punëve publike të lidhura me transportin ende nuk është në përputhje me standardet e BE-së. Konsulenti thotë se,

Albania (2012)	2,914.00 €
Kosovo (2011)	3,742.00 €
Bosnia (2011)	7,796.00 €
Serbia (2012)	9,039.00 €
Romania (2011)	9,303.00 €

Table 15 - Expenditure on Maintenance per Km (Euros/km) (Source: WB)



koordinimi i infrastrukturës së transportit me vendet fqinje - vendet e Ballkanit Perëndimor që përbëjnë Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi, Serbinë dhe Kosovën duhet të jenë në themel të politikave të transportit në Shqipëri. Vendet e

BE-së kanë miratuar një plan për një zonë të përbashkët të transportit evropian drejt një sistemi konkurrues dhe efikas të burimeve të transportit. Në kuadër të këtij plani deri në vitin 2030, 30% e transportit rrugor mbi 300 km distancë duhet të zhvillojë transportin hekurudhor.

Ministria e Mbrojtjes, mes batalionit të Forcave Speciale në Zall-Herr

Shqipëria 9 vjet në NATO, Xhaçka: Pjesë aktive e operacioneve të Aleancës

DEKLARATA

"Konfirmoj vullnetin politik të qeverisë se Forcat tona të Armatosura do të vijojnë të jenë pjesë aktive e operacioneve të NATO-s dhe e çdo përpjekjeje për ruajtjen apo rivendosjen e paqes, aty ku NATO dhe vendimmarrja e saj do ta gjykojë të domosdoshme", tha ministria.

qipërisë në të si një pikë kulmore dhe një arritje të jashtëzakonshme historike për vendin tonë. Ministria përmendi angazhimin e Forcave tona të Armatosura në operacionet e NATO-s në Bosnje dhe Hercegovinë, duke u shndërruar gjatë këtyre viteve në një vend që gjeneron dhe ofron siguri. "Pavarësisht se një vend i vogël dhe me mundësi të limituara, Shqipëria mbetet një ndër vendet më të përkushtuara në NATO dhe me kontribute të

genëshme në raport me vendin, popullsinë, Forcat e Armatosura dhe burimet ekonomike. Forcat tona të Armatosura numërojnë sot shumë misione dhe mbi rreth 7 mijë trupa të angazhuara në këto misione. Vendi ynë ka hyrë në hartën e vendeve që gjenerojnë dhe ofrojnë siguri. Forcat tona të Armatosura janë të përfshira në një zhvillim të vazhdueshëm dhe progresiv, në përshtatje me kërkesat e Aleancës si dhe ndryshimet në ambientin e sigurisë. Ato përditë e më tepër u përngja-



Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, dhe në Zall-Herr

jnë homologeve të tyre aleate, në veçanti sa i takon pajisjes, edukimit, trajnimit, të mendimit dhe të performancës", tha Xhaçka. "Jam e lumtur që në eksperiencën time si ministre e Mbrojtjes, e konstatoj këtë fakt jo vetëm në kontaktet e mia me strukturat e Forcave të Armatosura,

por edhe nga vizitat në terren e operacioneve, ku ato kryejnë misionin e tyre fisnik si ruajtës të paqes, në pikat e nxehta të globit në të cilat pagja është e kërcënuar", - u shpreh ministria, e cila theksoi edhe vendosmërinë e vendit tonë për të qenë përkrah çdo angazhimi të NATO-s.

Kryeministri në konferencën e PES: Shqipëria pret atë që meriton, negociatat

Tarifa e Rrugës së Kombit, Rama: Zgjidhje për banorët e Kukësit

"Nuk merrem me opozitën kur flas në anglisht"

Darina Tanushi

Shqipëria pret atë që meriton, rekomandimin për çeljen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian", deklaroi dje kryeministri Edi Rama në një dalje për mediat, në fund të Konferencës Ballkanike të Partisë Socialiste Evropiane, organizuar në Tiranë. Edhe në prani të Sergej Stanišev, presidenti i PES; Michele Nicoletti, presidenti i Asamblesë Parlamentare të KE-së dhe Aleksandar Andrija Pejovic, presidenti i Komisionit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar, Integrimin Europian dhe Euroatlantik, Rama u shpreh: "Fillimisht na intereson raporti i Komisionit, një raport teknik, i cili evidenton progresin e bërë dhe nëse vendi i ka kryer apo jo detyrat e shtëpisë. Komisioni, urojme dhe shpresojmë që t'i konsiderojë detyrat e kryera deri në këtë fazë dhe të japë rekomandimin e pastër pozitiv për çeljen e negociatave. Pastaj vjen vendimmarrja e shteteve që është përtej anës teknike, një vendimmarrje politike", tha Rama. "Në fillim të marrim raportin dhe uroj rekomandimin", tha Rama, duke shtuar se më pas do të kemi një periudhë kohe për të intensifikuar punën tonë për të gjitha vendet anëtare, që kanë nevojë për më shumë



Kryeministri Edi Rama, në konferencën e PES

përpjekje dhe për të marrë konsensusin e vendeve anëtare. "Kemi një axhendë intensive bashkë me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme dhe jemi të mirëpërgatitur për fazën tjetër. Edhe PES ka një rol të konsiderueshëm edhe për prezencën në parlamentet e vendeve të tjera", tha kryeministri. Sipas tij, "është një vendimmarrje politike, por raporti na bën më të fortë, ose më të dobët. Nëse kemi një raport të qartë dhe solid, ne kemi dëftësinë që kemi bërë detyrat e shtëpisë. Rëndësi ka që të marrim rekomandimin pozitiv tani. Është e udhës që të gjithë të fokusohen te rekomandimi", shtoi Rama. I pyetur

mbi qëndrimin e opozitës për protestën në Rrugën e Kombit, Rama u shpreh se, "kur unë flas anglisht dhe jam me miq që kuptojnë vetëm anglisht, nuk merrem me opozitën e vendit tim". "Problemi im sot dhe gjatë gjithë këtyre ditëve ka qenë dhe mbetet zgjidhja që duam dhe do t'u japim atyre, që janë realisht subjekt i sistemit të pagesës dhe patjetër që në fund do të vlejë çfarë ne do të bëjmë për njerëzit që jetojnë në Kukës", tha Rama. Presidenti i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, Michele Nicoletti vlerësoi ecurinë e reformave të ndërmarra nga qeveria shqiptare sa u përket të drejtave të njeriut, pavarësisht së pushtetit

SERGEJ STANIŠEV
Presidenti i Partisë Socialiste Evropiane, Sergej Stanišev u shpreh dje: "Është vërtet inkurajuese për Shqipërinë dhe për popullsinë e Shqipërisë që njerëzit të mund të kenë besim dhe të mendojnë që i gjithë sistemi i drejtësisë do të jetë transparent dhe jo është një kredit vetëm e zotit Rama dhe vetëm e Partisë Socialiste të Shqipërisë".

gjyqësor dhe luftës ndaj korrupsionit. "Ajo që kemi bërë ju në Shqipëri, në fushën e të drejtave të njeriut, pavarësinë e pushtetit gjyqësor, luftën ndaj korrupsionit është e rëndësishme dhe duhet të fuqizohet më tej", deklaroi Nicoletti. "Kemi ndjekur nga afër procesin e demokratizimit e përmirësimit e standardeve në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut dhe ndërtimit të një shoqërie të re civile në të gjitha këto shtete dhe më duhet të them se ky përmirësim, ky proces është vërtet serioz dhe tani më shpresoj të kemi pjesëmarrjen e plotë në Bashkimin Europian", u shpreh Nicoletti.



TAKIMI

Kryeministri takon politikanët kosovarë, Kurti: Taksa 5 euro, e lartë

Kryeministri Edi Rama u takua dje me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosja, Albin Kurti dhe atë të "Nismës", Fatmir Limaj. Rama është takuar me zyrtarët kosovarë në një lokal në Tiranë, vetëm një ditë pasi kryeministri shqiptar priti Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Temë diskutimi mes Ramës e Kurtit ka qenë dhe taksa 5 euro në Rrugën e Kombit. Kurti ka deklaruar se kjo taksë është shumë e lartë, pasi sipas tij, kosovarët janë të varfër. "Taksa 5 euro për Rrugën e Kombit është shumë e lartë. Kosovarët janë të varfër. Të vetmin det kanë këtë të Shqipërisë. Ia kam thënë edhe kryeministrit këtë gjë", ka thënë Albin Kurti, pas takimit me kryeministrit Edi Rama. Lidhur me dëbimin e 6 shtetasve turq nga Kosova, Kurti ka fajësuar qeverinë kosovare, duke thënë se dështoi. "Për dëbimin e shtetasve turq është faj i qeverisë dhe jo i Erdoganit. Qeveria ka dështuar. Institucionet e Kosovës e kanë trajtuar me shkelje situatën. Nuk ka pasur transparencë se çfarë ndodhi me 6 shtetasit që u dëbuan pa gjyq", shtoi Kurti. Të dy politikanët kosovarë ishin dje në Tiranë për shkak të pjesëmarrjes së tyre në konferencën ballkanike të organizuar nga Partia Evropiane Socialiste. Edi Rama i kërkoi me këtë rast Brukselit që të mbajë fjalën e të heqë vizat për qytetarët e Kosovës. "Për ne shqiptarët është me rëndësi që Bashkimi Europian të mbajë fjalën dhe të liberalizojë lëvizjen për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe jam i bindur se presidenti i Partisë Socialiste Evropiane ndan të njëjtin qëndrim", deklaroi kryeministri.

FIER - Fillimprilli ka nisur me protesta në vendin tonë. Pas "rebelimit" të banorëve të Kukësit, të cilët po kundërshtojnë me forcë taksën në Rrugën e Kombit, dje u hodhën në protestë edhe naftëtarët e ish-KPTHN-së në Ballsh. Rreth orës 10:00, ata u mbledhën para portës së uzinës, ku qëndronin gjithashtu forca të shumta policie private dhe të shtetit. Pjesëmarrësit në tubim, pasi kanë kordonin e policisë



Naftëtarët e Ballshit hidhen sërish në protestë, shpërthejnë me forcë dyert e rafinerisë

hynë me forcë në uzinë, duke shpërthyer portën. Protestuesit u vendosën para zyrave, ndërsa kërkuan që të vijojnë punën, pagat e prapambetura dhe zbatimin e kontratës. Ndërkaq, naftëtarët kërkuan që punëtorët, të cilët kanë nisur punën në reparatet e uz-

inës të bashkohen me ta, pasi ata janë zgjedhur në mënyrë selektive. Mësohet se është vendosur që asnjë punëtor nga sot e tutje nuk do të futet për të punuar në reparte të ndryshme. Me ardhjen e kompanisë që ka marrë në zotërim rafinerinë, sipas tyre

nuk janë bërë kontrata të rregullta, por kanë filluar punë vetë 150 që sipas punëtorëve, janë marrë në mënyrë selektive. Naftëtarët kërkojnë të merren të gjithë në punë, pasi janë në gjendje të keqe ekonomike. Nga 1000 punëtorë që kanë qenë në uzinën

në fjalë, aktualisht janë gjithsej 200 naftëtarë në punë. Të indinjuar, naftëtarët e Ballshit kërcënuan se do të vijojnë protestat deri në zgjidhjen e problemeve të tyre. Protesta mbështetet nga Sindikata e Naftëtarëve dhe Federata e Sindikatave të Industrisë. Prej disa muajsh, punonjësit ish-KPTHN-së kanë protestuar jo vetëm në Ballsh, por edhe në Fier dhe në Tiranë, duke e marrë edhe rrugën në këmbë.

36-vjeçari i masakrua nga shoku i ngushtë, familjarët: Të zbardhet e gjithë ngjarja

Krimi horror në Fier, Donjet Beqiraj: Dua të gjej kokën e vëllait tim

"Po kërkoj disa nga eshtrat e Kreshnikut në Daullas, që t'i bëj ceremoninë ashtu si duhet"

Ervis Kuci

FIER

Afro një muaj pas gjetjes së eshtrave të 36-vjeçarit Kreshnik Beqiraj në fshatin Daullas të Fierit, vëllai i viktimës ka dhënë detaje tronditëse lidhur me ngjarjen makabre të ndodhur më 22 qershor të vitit që shkoi. Donjet Beqiraj dje ka thënë se trupit të vëllait që u masakrua me çekic e sëpatë nga shoku i tij i ngushtë, Albert Zekaj, i mungon koka. Kjo pjesë e trupit të viktimës mungon në eshtrat e gjetura nga policia. Kjo e fundit vazhdon kërkimet, por ende nuk ka asnjë rezultat. Ndërkohë, Donjeti dhe disa shokë të tij kanë nisur kërkimet për gjetjen e kokës së 36-vjeçarit në fshatin Daullas, pasi ka informacione se koka dhe pjesët e tjera të pagjetura ndodhen ende në këtë zonë. Krimi makabër u zhbulua nga vetë autori Albert Zekaj në dëshmitë e tij. Pas arrestimit, 32-vjeçari nga fshati Kalldrun i Malësisë së Madhe deklaroi para policisë dhe prokurorisë se Kreshnikun e vrau në gjendje të dehur, pasi ai nuk kishte paguar qiranë e banesës, të cilën e ndanin bashkë. "Atë natë që ndodhi ngjarja kam qenë i dehur. Isha në një lokal tek 'Zogu i Zi' në Fier dhe piva. Kreshnikun godita disa herë me çekic në kokë, duke e lënë të vdekur në vend. Fsheha trupin që të ngrinte gjaku e mos të kishte shenja. Pas tri ditësh e copëtova dhe e mbluova me batanije. Kufomën e mbajta tri ditë në shtëpi dhe më pas e proposa në një kanal në fshatin Daullas", është shprehur Zekaj. Ndërkohë, vëllai i viktimës ka dyshime të forta se krimin e rëndë autori nuk e ka kryer i vetëm. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Donjet Beqiraj bën apel për zbardhjen e plotë të ngjarjes horror.



Vëllai i viktimës, Donjet Beqiraj



36-vjeçari i masakruar, Kreshnik Beqiraj

tur të gjitha eshtrat e vëllait tim, ndërsa kam informacion që eshtrat e tjera ndodhen akoma në këtë vend. Dua të mbaroj ky proces sa më shpejt. Të zbardhet e vërteta në bashkëpunim me Prokurorinë e Fierit që ka ndihmuar shumë deri sot. Të bëjë çfarë është e mundur. Kërkoj ndihmë nga shteti që çdo gjë të zbardhet sa më shpejt.

Iniciativën për kërkimin e keni marrë vetë, nuk keni njoftuar policinë për ndihmë?

Kam marrë të dhëna që këtu ndodhen akoma disa nga eshtrat e vëllait tim. Ne duam t'i gjejmë patjetër që t'i bëjmë ceremoninë ashtu si duhet.

Policia nuk ju ka ndihmuar?

Policia po bën punën e saj, por unë nuk mund t'i lë akoma eshtrat e vëllait në këtë vend. Më vjen shumë keq.

Pak kohë më parë shpërthejtë dyshime se personi që është aktualisht në pranga nuk është autori i vëllait të kësaj ngjarjeje. Vazhdoni të keni të njëjtat dyshime?

Unë kërkoj që shteti të vazhdojë punën e tij. E përsëris, kërkoj që kjo ngjarje të zbardhet sa më shpejt dhe çdo fajtor të arrestohet dhe të dalë para ligjit.

VRASJA NË 2017

Më 7 mars të këtij viti, një trup i pajetë u gjet i gëpusur në fshatin Daullas të Fierit. Në lidhje me këtë ngjarje u arrestua 32-vjeçari Albert Zekaj nga Malësia e Madhe, i cili gjatë marrjes në pyetje u tha: "Unë jetoja në një shtëpi me qira me Beqirajin. Ne kishim probleme me pagesën e qirasë që prej një viti. I kërkova lekët, por ai më tha se nuk kam. Atë natë që ndodhi ngjarja kam qenë i dehur. Kreshnikun e godita disa herë me çekic në kokë dhe pas 3 ditësh e copëtova dhe e proposa".

Kapet 59-vjeçari i shpallur në kërkim

Skandali me pronat në Lezhë, vetëdorëzohet futbollisti i Vllaznisë

LEZHË - Futbollisti i Vllaznisë, Renato Malotaj është vetëdorëzuar në Policinë e Lezhës. "ABC Neës" raporton dje se Malotaj ka qenë i shpallur në kërkim për tjetërsimin e pronave në Lezhë, për të njëjtën çështje, për të cilën akuzohet edhe kryebashkiaku dhe nënkryetari i Bashkisë së Lezhës. Nga hetimet e prokurorisë, rezultoi se futbollisti Renato Malotaj ka regjistruar 3300 metër katrorë tokë në Shëngjin.

Futbollisti i Vllaznisë ka qenë në kërkim që prej 16 marsit, kur policia ekzekutoi urdhër-arrestet për 22 persona në kuadër të operacionit "Ramishtëja 4" për abuzimin me tokat në bregdet. Ndërkaq, dje blutë e Lezhës kanë vënë në pranga edhe një person tjetër, lidhur me skandalin me tokat në bregdetin e Shëngjinit, çështje për të cilën u arrestua edhe kryebashkiaku i Lezhës, Fran Frkaj dhe më pas u la i lirë. Burime zyrtare nga policia



lokale bënë me dije se është prangosur 59-vjeçari Zef Gjini, banues në lagjen "Nënë Tereza" të qytetit të Lezhës. Ndaj këtij shtetasi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendim nr.86, datë 15.03.2018, ka caktuar masën e sigurimit personal "Arrest në burg", për veprën penale: "Falsifikimi i dokumenteve". Ndërsa, vijon puna për kapjen e personave të tjerë të shpallur në kërkim.

SHKURT

I gjendet kokainë në "Land Rover", arrestohet 22-vjeçari

KURBIN - Policia e Laçit ka vënë në pranga një 22-vjeçar, pasi iu gjet drogë në automjetin e tij. Bëhet fjalë për Jurgen Sokolin, i cili akuzohet për veprën penale "Prodhim dhe shitje e narkotikëve". Burime nga policia lokale bënë me dije se i ri u arrestua gjatë operacionit të koduar "Parkimi", pasi gjatë kontrollit të ushtruar në automjetin e tij tip "Land Rover" pranë një karburanti në aksin Laç-Kurbin iu gjet dhe iu sekuestrua një sasi prej 140 gr kokainë. Materialet në ngarkim të tij u përcollën për hetime të mëtejshme prokurorisë së Kurbin. Pritet që Gjykata e Shkallës së Parë e këtij rrethi të vendosë masën e sigurisë ndaj të riut Jurgen Sokoli.

Shëri në "Instagram", plagoset me armë zjarri adoleshenti

DURRËS - Një 18-vjeçar nga Durrësi është plagosur me armë zjarri, ndërsa është shpallur në kërkim autori. Sipas burimeve policore, ngjarja ndodhi rreth orës 17:30 në qendër të qytetit bregdetar, tek "Mazeoleumi i Dëshmorëve". Mësohet se ngjarja ka marrë shkas pas një konflikti mes dy të rinjve, që fillimisht ka nisur në rrjetet sociale. Pas sharjeve në "Instagram", adoleshenti S.K. është takuar me 17-vjeçarin me inicialet A.P., ku kanë debatuar sërish. Në sherr e sipër, ky i fundit ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar ndaj 18-vjeçarit. I plagosur është dërguar në spitalin e Durrësit, ku fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Ndërkaq, blutë kanë shkuar shpejt në vendngjarje dhe janë vënë në ndjekje të agresorit. Po punohet intensivisht për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje si dhe kapjen e 17-vjeçarit.

Gjenerali amerikan: Kosova me ushtri? Më parë nevojitet reformë kushtetuese

James Foggo: Shumë flamuj amerikanë në Shqipëri, surprizë e këndshme

"Rusia është fuqi rajonale, nuk është më një superfuqi"

GJENERALI
"Përfaqsa e Shqipërisë është 360 gradë dhe më duhet t'ju them se për një vend me këto përmasa dhe me forca ushtarake me këto përmasa, ka një shprehje amerikane - godisni shumë më lart se pesha së cilës i përkisni në boks. Po bëni një punë të shkëlqyer dhe keni kontributin e dytë më të lartë për frymë nga të gjitha vendet e NATO-s, ndaj më duhet ta përgëzoj Shqipërinë, qeverinë tuaj dhe ushtarakët tuaj për këtë".



← Ivanoviçit në Mitrovicën Veriore; unë isha atje më pas për të biseduar me kryebashkiakun e Mitrovicës Jugore, Mitrovicës Veriore dhe policinë gjyqësore, për t'i siguruar që KFOR do ishte aty për të ofruar një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur. Çështja e fundit me politikanin serb të Kosovës që kaloi kufirin, u arrestua, u trajtuan keq dhe më pas u kthye në Serbi dhe kjo sigurisht çoi në pasojat politike për qeverinë në Kosovë. Arsyja pse kjo më shqetëson është sepse deri në atë moment po zhvillohej një dialog i shkëlqyer midis Prishtinës dhe Beogradit dhe mendoj se ai dialog duhet të vazhdojë, me qëllim që në rajon të ketë paqe dhe stabilitet.

'News 24': A mendoni se siguria në Ballkanin Perëndimor është përmirësuar gjatë kësaj dekade?

Admiral Foggo: Absolutisht! Absolutisht! Mund ta shohësh kudo ku shkon. Ekonomi tregu në lulëzim, ndërtime të reja, të rinj që duan të udhëtojnë, të mësojnë, të studiojnë, bizneset që lindin. Së fundi takova dy sipërmarrës në Kosovë, njëri drejtor një kompani IT dhe tjetri një kompani e njohur për lëngje frutash që bën 'smoothie' më të mira në Kosovë, sipas komisarëve me të cilët kam folur, po hapin vende pune. Po rriten ekonomitë, ekonomitë tregu, e cila do çojë para tek autoritetet, tek populli dhe tek biznesi. Dhe shumë biznese mund

të lulëzojnë, në mënyrë që vendi të bëhet më i pasur dhe nga kjo pasuri, paratë mund të shkojnë tek njerëzit.

'News 24': A ka NATO një strategji për të neutralizuar ndikimet e reja gjeopolitike, sidomos ato ruse, për të depërtuar në Ballkanin Perëndimor?

Admiral Foggo: Mendoj se gjëja më e mirë që ka NATO është që jemi 29 demokraci dhe është e vështirë të thuash që ekziston demokraci në Federatën Ruse. Kishin zgjedhje atje. Nuk kishte shumë kandidatë dhe rezultati ishte më së shumti i siguruar për presidentin Putin. Nuk dukej sikur ekzistonte mundësia që çdo rus të votonte sipas ndërgjegjes apo për kandidatin e vet. Disave iu ndalua kandidimi në zgjedhjet presidenciale. Në nga ana tjetër kemi një demokraci të lirë dhe të drejtë dhe, kur ka mosmarrëveshje, njerëzit kanë mundësinë të votojnë, njerëzit kanë mundësinë të mos marrin pjesë në qeverisje, kanë mundësinë të marrin pjesë në qeverisje dhe që zëri i tyre të dëgohet dhe zëri i secilit është i barabartë. Duhet të them që ideat tona do të triumfojnë ndaj atyre që kanë synime dashakeqe ndaj perëndimit dhe ndaj demokracive të perëndimit.

'News 24': Admiral, cilat janë planet e NATO-s për të përmirësuar sigurinë në një rajon të brishtë si Ballkani Perëndimor?

Admiral Foggo: Fakti që jemi këtu dhe që vazhdojmë të trajnojmë dhe të ofrojmë mundësi për forcat tuaja të sigurisë, forcat tuaja ushtarake dhe shtabin e përgjithshëm për t'u bërë edhe më të zotë në fushën e tyre të mbrojtjes është diçka që NATO e bën. Më duhet ta përgëzoj Shqipërinë. Shqipëria është e përfshirë në shumë stërvitje dhe operacione, që janë përtej kufijve të saj, sepse keni ushtarakë shumë të zotë. Gjithmonë e kam admiruar personelin ushtarak shqiptar, qofshin në flotë, forcat ajrore apo ushtri. Jeni në Afganistan dhe mbështesni operacionin 'Mbështetja Vendimtare' dhe numri i trupave që kontribuoni pritet të rritet pak dhe mendoj se të gjithë në NATO janë të lumtur për këtë. Është një fushatë shumë e rëndësishme që përploqet t'i japë popullit afgan lirinë për të stabilizuar një vend që është plot me organizata të dhunshme ekstremiste. Jeni në Kosovë me një prani shumë të fortë. Jeni në veri, në operacionin 'Prania e Përfortuar Pararojë' në Danimarkë, po tregoni se jeni në solidaritet me aleatët balltikë. Jeni në Afrikë, me misionin trajnues të BE-së në Mali. Pra, përfaqsa e Shqipërisë është 360 gradë dhe më duhet t'ju them se për një vend me këto përmasa dhe me forca ushtarake me këto përmasa, ka një shprehje amerikane - godisni shumë më lart se pesha së cilës i përkisni në boks. Po bëni një punë të shkëlqyer dhe keni kontributin e dytë më të lartë për frymë nga të gjitha vendet e NATO-s, ndaj më duhet ta përgëzoj Shqipërinë, qeverinë



nga zëvendëssekretarja e Përgjithshme kur vizitoi së fundi kampin 'Film City', shtabin e KFOR, se në mënyrë që të ndodhë një tranzicion i Forcës së Sigurisë të Kosovës në diçka tjetër, me sa kuptohet një ushtri, duhet të ndodhë reforma kushtetuese. Sepse aktualisht nuk ka nën Kushtetutë që e lejon ngritjen e një ushtrie në Kosovë. Duhet të ketë një amendim të Kushtetutës dhe me procedurë, me ligj, një amendament kushtetues i pranuar nga i gjithë populli i Kosovës kërkon shumicë prej dy të tretash. Pra, nëse Kosova dëshiron të ecë përpara, përtej Forcës Kosovare të Sigurisë, që mendoj se janë shumë profesionistë dhe të zotë, do duhet të kryejnë reformë kushtetuese dhe të amendojnë Kushtetutën. Nëse e bëjnë këtë, mendoj që NATO

shpenzimet për mbrojtjen përsëri tek 2% me afat vitin 2024. Është për t'u përgëzuar kjo. Jo shumë vende e kanë marrë këtë angazhim, por Shqipëria e ka bërë dhe mendoj se do të keni përfitime prej kësaj, teksa modernizoni një flotë shumë të zotë dhe forci ushtarake shumë të zotë.

'News 24': Edhe një pyetje e fundit, admiral. Jeni komandant i Komandës së Forcave të Bashkuara Aleate, Napoli, komandant i Forcave Detare të SHBA për Europën dhe Komandant i Forcave Detare të SHBA për Afrikën. Sa e rëndësishme është fuqia detare e vendeve anëtare të NATO-s?

Admiral Foggo: Po bisedon me një oficer të marinës, ndaj mund të jem pak i anshëm, por mund të them se nga 29, 21 vende anëtare kanë një lloj force në det. Besoj se në Europë, po të shohësh hartën e Europës dhe shpreh formën e tokës në hartën e Europës, kupton se rrethohet nga uji - Arktiku në veri, Atlantiku Verior, hapësira Greqë-Islandë-Mbretëria e Bashkuar, Deti Balltik, Deti Mesdhe dhe Deti i Zi. Europa në fakt është një gadishull i rrethuar nga uji, ndaj mendoj se për mbrojtjen e Europës duhet të mbrojmë kufijtë në tokë, por edhe linjat detare të komunikimit, nga të cilat varet 90% e tregtisë. Prandaj liria e deteve, liria që të gjithë të përdorin linjat ndërkombëtare të transportit detar është thelbësore. Kushdo që kërcënon këtë duhet penguar. Prandaj të gjithëve na duhet një flotë e fortë, përfshi Shqipërinë dhe kjo është një pikë që e kam ngritur sot.

'News 24': Admiral, shumë faleminderit për këtë intervistë! Ishte një kënaqësi e vërtetë!

Admiral Foggo: Aurora, kënaqësi e vërtetë për mua! Faletenderit shumë ju dhe faletenderit popullit shqiptar, që më mirëpritën për dy ditë dhe pres me kënaqësi të kthehem sërish!

REFORMA

Nëse Kosova dëshiron të ecë përpara, përtej Forcës Kosovare të Sigurisë, që mendoj se janë shumë profesionistë dhe të zotë, do duhet të kryejnë reformë kushtetuese dhe të amendojnë Kushtetutën.

tuaj dhe ushtarakët tuaj për këtë.

'News 24': Autoritetet kosovare janë shprehur se këtë pranverë FSK do transformohet në Forcën e Armatosur të Kosovës. A e mbështet SHBA dhe NATO formimin e Forcave të Armatosura të Kosovës? Në këtë situatë, mendoni se NATO do të reduktojë praninë e trupave në Kosovë këtë vit apo në të ardhmen?

Admiral Foggo: Ma bëjnë vetë shpresë këtë pyetje. Ma bëjnë vetë kosovarët dhe përgjigja është gjithnjë e njëjta: që NATO e ka bërë shumë të qartë, me deklaratat shumë të forta dhe deklaratat politikash nga ministrat e Jashtëm,

do të rishikonte përmasat e pranisë së forcës së sigurisë dhe do të vendoste se çfarë do të donte të bënte në të ardhmen.

'News 24': Në lidhje me Shqipërinë, çfarë mendoni për shpenzimet e saj për mbrojtjen?

Admiral Foggo: Vite përpara, në 2009-ën ose pak më vonë, shpenzimet e Shqipërisë për mbrojtjen ishin rreth 2% e PBB. Për disa vite ra në 1% ose më poshtë. Mendoj se kohë e fundit, qeveria shqiptare, me kërkesë të ushtarakëve dhe me kërkesë të aleatëve dhe partnerëve të NATO-s dhe qendrës në Bruksel ka rivilësuar shpenzimet e saj për mbrojtjen dhe është zotuar të rrisë

Shëndetësi

Njeriu duhet të luftojë për të zbutur sëmundjen e këtë mund ta bëjë fillimisht duke mbajtur një higjienë sa më të pastër personale, e nëse pihet ujë më shumicë, organizmi fillon të vetëpastrohet nëpërmjet urinimit. Por nëse përdoret brokoli rreth 200 gram në ditë, arrijmë të shkatërrojmë bakterin **Esherika Koli, por edhe konsumimi i frutave të pyllit, bën të mundur prodhimin e proteinave në trupin e njeriut, e rritet numri i leukociteve, të cilat bëhen tepër luftarake ndaj baktereve.**



Mjeku popullor: Perimet e frutat e palara, shkaktari kryesor i sëmundjes

Voltiza Duro

Infeksionet urinare, krye shkaktohen nga bakteret, ku veçanërisht kryeson bakteri Esheria koli. Këto baktere japin infeksione në pjesën e vezikës urinare, në ureter, e vlen të theksohet se më të predispozuarit për tu prekur janë fëmijët e vegjël, femrat, pjesërisht meshkujt si dhe ata persona që mund të kenë infeksione të prostatës. Esheria Koli është një bakter, i cili ka një gjatësi nga 200-1000 nanometër, pra nëse e zmadhojmë i një herë, do të arrijë madhësinë e një kokrize sheqeri. Këto baktere, të cilat quhen ndryshe edhe "xhuxhët e lartë që kalërojnë", kanë një formë cilindrike të mbuluara me disa si qimëza të holla, nëpërmjet të cilave arrijnë të realizojnë lëvizjen dhe zhvendosjen në organizmat e gjalla. Këto baktere kryejnë një funksion të rëndësishëm në organizmat e ripërtypësve si gjedhët, lopët, dhentë, dhitë apo derri. Por edhe te njeriu këto lloj bakteresh gjenden në zorrë dhe trashë dhe përpunojnë ushqimet që janë të forta, ndërsa kur arrijnë të kalojnë nga sistemi i jashtëqitjes në atë urinar, këto baktere, arrijnë të krijojnë problematika nga më të ndryshmet.

SHKAKTARËT DHE SIMPTOMAT

Këto baktere që shkaktojnë infeksione urinare, mund të merren kryesisht nga konsumimi i ushqimeve të palara, nga ambientet publike, vendet ku rrinë bagëtitë, uji i ndotur apo mishi i pagatuar mirë. Disa nga simptomat që mund të shfaqë prania e këtyre baktereve në organizëm janë diarje me gjak; fryrje barku dhe zorrësh, të shoqëruara me dhimbje; djegie e urinës (edhe pas urinimit); temperaturë të lartë si dhe insuficiencë renale. Në përgjithësi nëse fermerët plehojnë tokat me pleh të padekompozuar mirë, ata mund të ndotin perimet e frutat me duart e tyre të papastruara. Nëse ky pleh, nëpërmjet grimcave të dheut, mund të ngjitet te frutat e perimet, së bashku

YLLI MERJA: Si të luftoni infeksionet urinare me bimë medicinale

"Efektet e mrekullueshme të çajit të koprës"



Mjeku popullor
Ylli Merja

me bakterin Esherika Koli. Vlen të theksohet se ky bakter nuk shkatërrohet edhe gjatë transportit, pasi diçka e tillë mund të ndodhë vetëm në habitate me temperaturë mbi 70 gradë celsius. Kështu

që rekomandohet që perimet apo frutat të shpëlahen mirë para konsumimit në ambientet tona familjare.

TRAJTIMI ME BIMË MEDICINALE

Nëse këtë bakter e

luftojmë me antibiotikë, atëherë nuk kemi gjetur rrugën më të mirë të mundshme. Kjo pasi në organizmin e njeriut gjatë këtij lloj trajtimi, do të fillojnë të lirohen me shumicë qeliza

helmuese dhe njëkohësisht arrin që të ashpërsohen simptomat e këtij lloj bakterit. Pra, përdorimi i antibiotikut në këto raste nuk është aspak efektiv. Njeriu duhet të luftojë për të zbutur sëmundjen e këtë mund ta bëjë fillimisht duke mbajtur një higjienë sa më të pastër personale, e nëse pihet ujë më shumicë, organizmi fillon të vetëpastrohet nëpërmjet urinimit. Por nëse përdoret brokoli rreth 200 gram në ditë, arrijmë të shkatërrojmë bakterin Esherika Koli, por edhe konsumimi i frutave të pyllit, bën të mundur prodhimin e proteinave në trupin e njeriut, e rritet numri i leukociteve, të cilat bëhen tepër luftarake ndaj baktereve. Edhe lëkura e dardhës apo limonit arrin që të pakësojë efektin e Esherika Kolit, duke i zvogëluar si numër. Ndërkohë edhe çaji i koprës dhe çaji i dëllinjës japin efekte të mrekullueshme në

trajtimin e infeksioneve urinare, pasi kanë veti antibakteriale shumë të mira.

PROPOLISI I BLETËS

Ndërkohë edhe propolisi i bletës është një antibiotik i çmuar natyral, antiviral, antiflamator, antimykotik, antibakterial, antioksidant, imunostimulant, antiseptik e antiparazit. Ky produkt i bletës është një nga medikamentet më të vjetra e më të njohura nga njerëzimi. Propolisi rekomandohet të përdoret kundër diabetit; ftohjes; kisteve; alergjive; infeksioneve të gojës, veshkave apo tëmthit. Gjithashtu, luan një rol të rëndësishëm në kurimin e kolitit, ulcers, mykut dhe krimbave të zorrëve, por gjen përdorim edhe në trajtimin e hazmatikës së fytyrës dhe reumatizmit. Ky medikament ndihmon në kurimin e disa sëmundjeve të tjera si asma, spondiliartroza, parkinsoni apo hernia discale. Propolisi është një kombinim komponentësh me natyrë aromatike e fenolike, të pasura me një numër të madh substancash të shumëllojshme mes tyre. E veçanta e këtij medikamenti qëndron në pasurinë e madhe të flavonoideve, falë të cilave propolisi siguron veçorinë antimikrobike. Sipas disa studimeve, rreth 1/3 e fraksioneve të propolisit të tretshëm në alkol etilik, ka natyrë flavonoide, mes të cilave është identifikuar galangina dhe pinocebrina. Këto të fundit kanë efekte shumë të mira bakteriostatike që përfaqëson veprimin antihelmues.



Manastirliu: Do të pranohen 249 mjekë të rinj Specializantët në mjekësi, mbyllet faza e parë, testohen 333 kandidatë

Ditën e djeshme është zhvilluar testimi me gojë për 333 kandidatë që kërkojnë të vazhdojnë specializimet në një prej degëve të Mjekësisë. Pas përfundimit të konkursit, vetëm 249 mjekë të rinj do të kenë mundësinë të vijojnë studimet këtë vit për një program të caktuar specializimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu ndoqi nga afër fazën e parë të konkursit dhe theksoi se kuotat janë shtuar duke plotësuar në këtë mënyrë nevojat me mjekë në të gjithë vendin. "Pas 4 vitesh

MINISTRJA

"Pas 4 vitesh ndërprerje, specializimet jo vetëm po vijojnë çdo vit, por kuotat janë shtuar, duke krijuar më shumë mundësi për diplomimin e mjekëve specializantë për të plotësuar në këtë mënyrë nevojat me mjekë në të gjithë vendin", - tha Manastirliu.

ndërprerje, specializimet jo vetëm po vijojnë çdo vit, por kuotat janë shtuar, duke krijuar më shumë mundësi për diplomimin e mjekëve specializantë për të plotësuar në këtë mënyrë nevojat me

mjekë në të gjithë vendin. Këtë vit janë 249 kuota, nga të cilat 125 janë kuota të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pra mjekë specialistë që në përfundim të studimeve do të

shërbejnë në spitalet tona, aty ku ka nevoja për mjekë sipas specialiteteve", - tha Manastirliu. Pas fazës së parë të konkurrimit, e cila përfundoi dje, do të zhvillohet faza e dytë, ajo e dosjeve për secilin kandidat dhe faza e tretë është ajo e testimi me shkrim.

Këtë vit diplomohen 40 mjekë të parë specialistë, pas një bllokimi 4 vjeçar nga politika e vjetër, ndërsa vitin e ardhshëm plotësohet cikli i parë 4-vjeçar prej rikthimit të specializimeve nga ku



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu në fazën e parë të konkursit

do të kemi 300 mjekë specialistë. Ndërkaq, deri më tani 2902 qytetarë kanë marrë shërbim të specializuar afër vendbanimit, për të cilin më parë detyroheshin të drejtoheshin drejt spitaleve universitare të Tiranës për

këto shërbime. Po ashtu po zgjerohet programi i bosit me mjekë të specializuar që kanë pranuar të shkojnë në spitalet rajonale për ofrimin e shërbimit me kohë të plotë aty ku janë nevojat.

Ministria e Arsimit premtor rritje pagash me 40% për mësuesit brenda mandatit

Rishikim i mesatares për pranimet në fakultetet e edukimit

Nikolla: Kriteri, nota duhet të jetë mbi 7



Voltiza Duro

Kriteret e pranimit të kandidatëve që dëshirojnë të zhvillojnë studimet për mësuesi do të rishikohen dhe përmirësohen, për të pasur një arsim sa më cilësor. Kjo deklarata është bërë ditën e djeshme nga ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla në takimin me rektorët e dekanët e fakulteteve të edukimit, gjatë të cilit u diskutua mbi mundësitë e përmirësimit të formimit cilësor të mësuesve të rinj. Ministria bëri me dije se 23% e të pranuarve në programet e mësuesisë janë me notën mesatare nën 7 dhe theksoi faktin se në vijimësi do të synohet rritja e notës mesatare të provimeve, e cila duhet të jetë mbi 7-të. "Ne kemi bërë, në fakt, me shumë kujdes gjithë projektionet, kemi parë analizat në rang numrash, në fakt, për të gjithë institucionet që ofrojnë programet nga ku prodhohen mësues, shohim që 65% e të gjithë të pranuarve në të gjithë universitetet tona në programet e mësuesisë, janë me notën mesatare nën 8 dhe 23% janë me notën mesatare nën 7, këto janë ref-



Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, Lindita Nikolla në takimin me rektorët e dekanët e fakulteteve të edukimit

erenca duke pasur parasysh të gjithë fakultetet e edukimit, pra gjithë institucionet e arsimit të lartë", - tha Nikolla në fjalën e saj. Më tej kjo e fundit bëri me dije se ka diferenca nëse futesh

dhe shikon situatën nga njëri universitet në tjetër. Gjithashtu, Nikolla shtoi se ka universitete që shifra e mësuesve me notë mesatare nën 7 apo të pranuarve në vit të parë me notë mesatare

nën 7, është edhe mbi 50%. "Këto kërkojnë qartësi, patjetër studimin e duhur, seriozitetin e duhur, por edhe një vullnet të shprehur që secili prej aktorëve në këtë proces të bëjë vetë detyrat e

PAGAT

"Po ashtu jemi të angazhuar që profesionin e mësuesve ta bëjmë të kërkuar. Së pari, është për t'i kthyer mësuesit dinjitetin, por edhe pagën edhe pse sot mësuesit kanë një nivel të themi të kënaqshëm të pagës, ne jemi të angazhuar që në këtë mandat paga e mësuesit të pësojë një rritje deri në 40%", - theksoi Nikolla.

kaq të madh me rëndësi kombëtare, siç është ai i formimit të mësuesve" - deklaroi ministria e MASR.

RITJJA E PAGAVE

Gjatë takimit me rektorët e dekanët e fakulteteve të edukimit, ministria e Arsimit, premtori se brenda mandatit, pagat e mësuesve do të rriten me 40%. Gjithashtu, ajo shtoi se për të gjithë mësuesit do të ofrohet mundësi për të konkurruar në bazë të meritokracisë në portalin e ri "Mësues për Shqipërinë". "Po ashtu jemi të angazhuar që profesionin e mësuesve ta bëjmë të kërkuar. Së pari, është për t'i kthyer mësuesit dinjitetin, por edhe pagën edhe pse sot mësuesit kanë një nivel të themi të kënaqshëm të pagës, ne jemi të angazhuar që në këtë mandat paga e mësuesit të pësojë një rritje deri në 40%", - theksoi Nikolla.

Veliaj: Janë reduktuar ndjeshëm problemet mes qytetarëve

Vijon procesi i zgjedhjes së administratorëve të pallateve

Rreth 2800 mijë pallate në Tiranë kanë zgjedhur kryesitë e tyre për administrimin e mjediseve në bashkëpunësi, ndërsa në 500 të tjera janë zgjedhur edhe administratorët. Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj zhvilloi një takim me administratorët e zgjedhur dhe grupin e Task-Forcës,

ku vlerësoi punën e realizuar deri më tani dhe u shpreh se zgjedhja e administratorëve të pallatit ka ulur ndjeshëm problemet mes qytetarëve. "Fakti që një pjesë e madhe e këtyre problematikave kanë rënë është një lajm shumë i mirë për qytetin", - tha ai. Veliaj theksoi se për Bashkinë e

Tiranës dhe qytetarët e saj është shumë e rëndësishme që procesi të vazhdojë me të njëjtin ritëm. Ai nënvizoi faktin se ky proces përveçse sjell më shumë rregull në administrimin e problematikave të banorëve të pallateve, është një mundësi shumë e mirë edhe për punësimin e një numri të

konsiderueshëm personash, të cilët më parë ose ishin të papunë ose kishin dalë në pension. "Më jep kënaqësi fakti se qindra vetë i kanë gjetur punë vetes falë angazhimit të komunitetit. Janë punësuar njerëz, jo vetëm Task-Forca, por sa njerëz po punojnë si administratorë, çojnë një rrogë në shtëpi, që më përpara ose mund të kishin dalë në pension të parakohshëm ose mund të ishin të paangazhuar", - theksoi kryebashkiaku.



Kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj zhvilloi një takim me administratorët e zgjedhur dhe grupin e Task-Forcës

SHKRIMTARET NE DIKTATURE DOKUMENTET


EKSKLUZIVE / Zbulohet raporti sekret i Dhimitër Fullanit, shefi i redaksisë së poezisë, dramës dhe kritikës në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri" për poetët me ndikime dekadente

Letra për Ramizin: Asnjëri nga ne nuk iu kundërvu mendimeve liberale të Gjergj Zhejit

Raporti i Fullanit: Si i spastruam poezitë moderniste të Xhevahir Spahiut, Ylli Polovinës, Frederik Reshpes, Faslli Halitit dhe Sadik Bejkos

Dashnor Kaloçi

Menjëherë pas fjalimit të Enver Hoxhës më 15 dhe 16 mars të vitit 1973 në aparatën e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, ku si temë kryesore ishte: "Lufta kundër shfaqjeve të huaja dhe liberale në art kulturë dhe ndikimi i tyre në të gjithë jetën e vendit", ashtu siç kemi parë edhe në mjaft nga kapitujt e tjerë të këtij libri, në të gjitha institucionet kulturore dhe artistike të vendit, organizatat bazë dhe komitetet e partisë së rretheve, u mbajtën një sërë mbledhjesh me analiza të shumta ku u "punua" fjala e Enver Hoxhës. Në këtë kontekst, edhe në Ndërmarrjen Botuese "Naim Frashëri", të gjitha redaksitë përkatëse të saj, iu nënshtruan një analize të hollësishme të punës që kishin bërë deri në ato kohë, jo vetëm me ato që ishin botuar, por edhe me veprat dhe vëllimet që nuk e kishin parë ende dritën e botimit për shkak të problemeve të tyre me "ndikimet e huaja". Lidhur me këtë bën fjalë edhe dokumenti që po publikojmë në këtë pjesë të librit, (materiali është shkëputur nga një dosje voluminoze me siglën sekret) i cili mban datën 19 prill 1973, dhe ku shefi i redaksisë së Poezisë, Dramës dhe Kritikës, Dhimitër Fullani, ka bërë një informacion për Komitetin Qendror, konkretisht për Ramiz Alinë, sekretarët përkatës që mb-



Gjergj Zheji

ulonnte artin, kulturën dhe propagandën. (Ramizi nuk ka bërë asnjë shënim në dokumentin në fjalë, pasi siç duket ka qenë i kënaqur me punën e Fullanit). Në këtë raport-informacion, Dhimitër Fullani ka analizuar me detaje dhe hollësi të gjithë punën që ajo redaksi ka bërë gjatë gjithë vitit 1972 me botimet në gjuhën e poezisë. Kështu ai ka marrë në analizë një numër të madh poetësh duke kaluar në një "sitë të imtë" të gjithë punën e tyre dhe duke bërë një spastrim të thellë në të gjitha vëllimet poetike të vitit 1972. Ajo që bie në sy në raport-informacionin në fjalë, është se "spata" e shefit të redaksisë së Poezisë, Dramës dhe Kritikës, Dhimitër Fullani, ka rënë "pa mëshirë" jo vetëm ndaj poetëve, duke filluar nga ata më me

përvojë dhe deri tek më të rinjtë, por ai ka kritikuar edhe Kryetarin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Dhimitër Shuteriqin, i cili kishte lejuar dhe nxitur botimin e vëllimit poetik "Më jepni një emër", të Fatos Arapit, libër i cili u ndalua që të dilte në qarkullim. Jo vetëm kaq, por Fullani nuk ka nguruar që në raport-informacionin e tij të pasqyrojë me hollësi edhe përplasjet që ai ka pasur "për shkak të detyrës" me Fatos Arapin, poetin që edhe pse "vinte nga Lufta" mbeti "problematik" në krijimtarinë e tij deri në fundin e viteve '80-të kur dhe u shemb regjimi komunist. Për më shumë rreth kësaj, na një raport-informacioni në fjalë që po e publikojmë të plotë në këtë pjesë të librit.

(vijon nga numri i kaluar)

RAPORT

Mbi rezultatet e rishikimit të materialeve të redaksisë pas fjalimeve të shokut Enver

Shkurtimisht po përmëndim këtu se, për ruajtjen e përmbajtjes së shëndoshtë të vëllimeve tona poetike, redaksia i ka dhënë rrugë të lirë botimit, prirjes drejt thellimit të meditacionit në krijimtarinë poetike, që po theksohej progresivisht, deri sa meditacioni i ka shërbyer përgjithësisht artistik dhe thellimit të mendimit të qartë e të shëndoshtë lirik, kur meditacioni ka shërbyer për ta shkruar botën intime të poetit me unën e përgjithshëm shoqëror, mbasi thellimi i një meditacioni të këllillë është dëshmi kryesore për

“

Së shpejti libri më i ri, "Shkrimtarët dhe artistët në diktatin komunist" të gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

rritjen e pjekurisë të artit poetik. Por redaksia e ka përjashtuar poezinë kur mendimi poetik qëndron mbyllur vetëm brenda subjektit të poetit, ose kur meditacioni në poezi bëhet përcues i një mendimi të huaj dhe hermetik. Redaksia ka hequr me dhjetra poezi të këtitilla sidomos këto vitet e fundit si tek vëllimet e Xhevahir Spahiut, Agim Gjakovës, Hiqmet Meçës, etj. Ose i ka përmbysur krejt vëllimet dhe autorët kanë qenë të detyruar të sjellin vëllim të ri, pas vërejtjes së studiuar dhe pas një bashkëpunimi të ngushtë me autorët.

Për variantin e ri, p.sh. që i erdhi redaksisë pas kthimit të vëllimit me vjersha e poema të Frederik Reshpes "Në këtë qytet", një nga recenzenat, që kishte kaluar dy variantet e para nëpër duar, Lirim Deda, thotë: "Përmbledhja e re e poetit Frederik Reshpja, që i ka paraqitur ndërrmarjes për botim, mendoj se justifikon plotësisht këmbnguljen e asaj redaksie për ta ndihmuar autorin me vërejtje dhe



sugjerime. Nuk dua të them me këtë se poeti kishte nevojë për teori, por mendoj se ai kishte shumë nevojë për të njohur vetveten si poet, për të parë seriozisht jo vetëm vetëm misionin e tij, por edhe aftësinë e tij, për ta drejtuar këngën e zëmrës së tij tek masat e gjëra të lexuesëve të pastër, të kuptueshme, të bukur, të shëndetshme".

Megjithkëtë, vetëm pas një risedeksionimi e redaktimi të thellë nga redaksia, libri është dërguar në shtyp në një nivel mjaft të kënaqshëm. Edhe pas tërë këtij pastrimi e rigjenerimi, na u desh t'i heqim edhe dy vjersha të tjera pasi e tërhoqëm nga shtypshkronja.

Theksoj se bashkë me ciklin e nxjerrë nga vëllimi "Në këtë qytet", autori ka botuar në Nr. 6 1972 të "Nëndori" edhe vjershën "Duke u kthyer në vendlindje", e cila nuk kuptohet fare dhe mund të merret si një nga vjershat tipike moderniste goftë nga përmbajtja dhe goftë nga forma. →



Xhevahir Spahiu



Ylli Polovina



Frederik Reshpja




Faslli Haliti



Ramiz Alia

← Një vit më parë Milanov Kallupi paraqiti vëllimin për botim. Ne vumë theksin në kërkesa të rëndësishme për të hequr dorë nga konceptimi surrealist, që autori t'u largohej ekuivoqeve e hermetizimit, të trajtonte tematika të rëndësishme, të rreshte maninë e figuracionit dhe të ngrente nivelin artistik etj. Pasi iu rikthye katër herë Milanov Kallupit, redaksia ia arriti qëllimit dhe vëllimi u hodh në shtyp, si një vepër interesante, me tematikë të pasur, plot partishmëri dhe me një frymë të shëndetshme, qoftë për sa i përket formës e qoftë për sa i përket përmbajtjes.

Po ashtu prirja e poezisë sonë e theksuar drejt kërkimeve për pasuri të larmishme shprehesh figurative është vlersuar kurdoherë në mënyrë të diferencuar gjatë praktikës sonë seleksionuese dhe redaktuese. E kemi përkrahur kur figuracioni i ka shërbyer ngritjes së nivelit artistik të poezisë, kur i ka dhënë gjerësi dhe thellësi men-



Sadik Bejko

dimit të shëndoshë poetik, por kur kërkimi i figuracionit është kthyer në qëllim të vetvetes ne e kemi seleksionuar nga vëllimet tona, pavarësisht se diçka edhe na ka shpëtuar rastësisht, me përjashtim të Fatos Arapit, për të cilin u fol. Kemi kthyer e seleksionuar vjershë për vjershë vëllime të tëra si ato të Ylli Polovinës, P. Çerkezit, K. Zharos, e të shumë të tjerëve nga figuracionet capraze alogjike etj, që shprehin një tendencë formalizmi. Po një punë të thellë seleksionuese nuk bëjnë organet periodike dhe kjo është një nga arsytet që na ka dalë një punë e madhe këtu, të cilën nuk po e përballojmë dot sa duhet.

Për të pasur një ide mbi ndryshimin midis kritereve tona në botimet poetike dhe të organeve periodike, po përmëndim disa raste karakteristike.

Vjersha "Holta" e Faslli Halilit e kthyer nga ne si vjershë me figuracion manierist, është botuar në "Drita", 22.X.1972. Vjersha "Rrënjët" e Xhevahir Spahiu e hequr nga ne, se ka një vështrim pa perspektiv për klasën punëtore, është botuar në "Drita", 23.IV.1972. Poezi e errët fragmentare "Kur mbledh këngët popullore", e hequr nga ne, është botuar në "Drita", 14 maj 1972 etj.


Nuk bëhet një punë e studjuar redaktuese për të shpëtuar poezitë nga dobësitë e mendime të gabuara për të përfitur kështu prej tyre poezi të mira. Vjersha "Lumi" e Sadik Bejkos ("Drita", 2 korrik 1972) e përdiktuar, është e errët kontradiktore, kurse tek vëllimi ynë, e redaktuar dhe e krehur, e jep qartë idenë e njeriut që shkon

drejt një qëllimi të madh nëpërmjet një jete aktive shoqërore. Po ashtu vjersha "Meditim" dhe "Rrënjët" ("Drita", 2.IV.1972), të gabuara, dolën poezi të mira, kur ne iu hoqëm disa vargje në marrëveshje me autorin dhe i futëm në vëllim, etj.

Rastet e shkarjeve midis veprave që u tërhoqën nga shtypi veçanërisht librat e Miho Gjinit, Fatos Arapit e Gjergj Zhejit janë të rënda, por ato dhe gjithë veprat e tjera të kësaj kategorie u eliminuan dhe nuk i vajtën lexuesit si libra, megjithë gadi i tërë materiali i tyre është botuar nëpër organet e shtypit. Që të jemi realist, asnjëri nuk i kritikoi artikujt e botuar me kohë të Miho Gjinit, për njëanshmëri. Po ashtu asnjëri nuk i është kundërvënë deri tani mendime liberale të Gjergj Zhejit në artikullin që ne po bëhim nga vëllimi i tij, mendime këto që zhvillohen më gjërë tek artikulli i tij kritik kundër veprës së Razi Brahimit "Kur flasim për poezinë", botuar në "Nëndori" nr.3.1973. Këto mendime, që para fjalimeve të shokut Enver konsideroheshin suksese të reja për kritikën tonë, do të bëhen objekt kritike tani e tutje. T'i themi gjërat ashtu siç janë. Absurditeti më i madh lidhur jo vetëm me rastin e Fatos Arapit, por me tërë tendencën e hermetizimit në poezi është artikulli i Kudret Velçës "Nga mbeturinat konservatore, tek ndikimet moderniste", botuar në "Nëndori" Nr.6-1972, ku i thoshte të zezës e bardhë ditën për diell për ta përligjur një shkarje kaq të rëndë në poezi më vjershat më hermetike që ishin botuar ndonjëherë tek ne.

Tek pastrimet e pjesëshme të veprave në shtyp nuk kemi të bëjmë me lëshime tepër të rënda si me ndonjë poezi me frymë reaksionare e fund e krye të gabuar ideologjikisht, apo me ndonjë mani të tillë figuracioni si "Fiku i detit". Por kur i shikon të gjitha së bashku këto paqartësi të mendimit e të shprehjes poetike këto shprehje ekuivoqe apo atmosferë sentimentale, që filluan të përligjen nëpër ambientet letrare, del qartë se edhe në redaksinë tonë kish filluar të bëjë majë ndikimi modernist. Këto vatra fillestare të infektuara do të përhapnin epideminë në tërë vëllimet tona poetike. Midis nesh ka ndonjë shok që kujton se puna e redaktorit nuk duhet lidhur me mendimin që shpreh ai në bisedë a në shtyp. Po i rikujtoj shokut Pandeli Koçi vërejtjen me vënd që i bëri Drejtori në raportin e analizës vjetore lidhur me artikullin e tij kundër Razi Brahimit, ku midis të tjerash i thotë: "Në rastin e dhënë, para së gjithash nga shoku Pandeli Koçi që i kundërpërgjigjej Razi Brahimit me një artikull të tijin duhej pohuar se ajo poezi ishte e gabuar dhe, si e këfillë, e pabotueshme dhe poezi të tilla s'duhet të gjejnë vënd të ne. Kredoja e redaktorit të Shtëpisë Botuese duhej të që shprehur hapur për vetë faktin letrar të dhënë. Duke u konfonder dhe shpërndarë në polemikë për çështjen e dorës së dytë, Pandeli Koçi kreu gabimin tjetër më të madh, duke lënë të aludohet se nuk duhet të alarmohemi për ndikime, sepse ato s'janë veçse një gërvishitje dhe çiban gjoja pa rëndësi në zhvillimin e poezisë sonë".

Pikërisht këtë vërejtje ja ka bërë edhe shefi i redaksisë Dhimitër Fullani, kur ai po merrej me hartimin e këtij artikulli, se po i



kundërvihej një kritike për poezinë hermetike, kundër së cilës ne të gjithë dhe vetë ai po luftonte çdo ditë në redaksi. (Dhe Pandi më parë ka qenë intrasigjent sidomos kundër poezisë hermetike). Kjo gjëndje kontradiktore tek Pandi ishte rezultat i konceptit tolerant ndaj shfaqjeve liberale në poezi, që nuk mbeti fare pa pasoja në edhe në praktikën e tij si redaktor. Shokut Pandi i shpëtoi edhe një poemë e tërë si ajo e Bajazit Cahanit, "Në pritje", me një frymë sentimentale, qaramene e krypur sa për nishan me do vargje ku shprehet ndonjë protestë kundër privimit të dashurisë nga koncepti e zakoni konservator, vargje këto të futur në kallëp, që nuk përligjen nga struktura kompozicionale e kësaj poeme të konceptuar e të shprehur që në thelb gati si poezitë erotike sentimentale të së kaluarës.

Po të kuptohemi mirë: Këtu u mundam të shohim problemin nga tërë anët, se fenomenet janë kurdoherë të lidhura e të ndërvarura. Eshhtë fakt se edhe shëmbujt që sollëm më sipër, kjo redaksi nuk mund të veprojë e pavarur nga tërë aktiviteti letrar i vëndit me të mirat dhe dobësitë e tij. Gjithashtu duhet të themi se duke i dhënë vënd edhe shkaqeve të jashtëme të këtyre shkarjeve të brendëshme, këtë nuk e kemi bërë me qëllim për të larë vetveten se

të gjithë ne, duke filluar nga shefi i redaksisë, mbajmë përgjegjësinë kryesore për çdo shkarje. Po ashtu mban përgjegjësi dhe përgjegjësi edhe drejtori, shoku Ali Abdihoxha, i cili ka lidhje direkt me redaksinë e poezisë. Pavarësisht nga intensiteti i presionit, ne nuk duhet të kishin lejuar asnjë simptomë nga këto ndikime.

Nga sëmundja ime dhe rishikimi i këtyre materialeve, vetëm këto ditët e fundit është grumbulluar një material i madh në redaksi. Kush do t'i japë udhë këtij? Autorët kërkojnë të marrin përgjegjësinë e veprave, ose veprat t'u futen në shtyp. Këtu nuk lejohen as vonesat në evadimin e materialit as edhe gabimet jo vetëm për ato që futen në shtyp, por edhe ato për përligjet. Vetëm dy përgjigje më kanë kaluar mua me ndonjë ngatërrësë, ajo e Vangjush Zikos dhe e Miliano Stefës, kur kanë lëvizur redaktorët nga kjo redaksi dhe është bërë çështje deri në Komitetin Qëndror. Dhe me shumë të drejtë. Po për mosintererimin e eprorëve për ta plotësuar redaksinë me forcat e nevojshme kush përgjigjet? Le të mbetet pra ky raport me këtë pikëpyetje në fund.

Le të mbetet pra ky raport me këtë pikëpyetje në fund.

SHEFI I REDAKSISE SE POEZISE
DRAMES DHE KRITIKES
(Dhimitër Fullani)

REAGIMI

KAMPI I TEPELENËS

Autoriteti i Dosjeve: Të shmangen shprehjet deterministe

Fatmira Nikolli

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, përgjegjës për mbështetjen e kërkimit shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, ka bërë me dije dje ecurinë e projektit të muzealizimit të Kampit të punës së detyruar në Tepelenë. Që prej deklaratave të prof. Pëllumb Xhuffit, që shkaktuan furtunë në opinionin publik, Autoriteti që e ka vënë në qendër të punës së vet atë kamp, nuk kishte reaguar zyrtarisht.

Një javë pasi çështja e kampit të Tepelenës, është bërë debat publik, Autoriteti ka "reaguar" zyrtarisht, duke sqaruar se projekti për muzealizimin e kampit, parashikon rikthimin në identitet, si kamp dëbimi të një prej kaponëve, vendosjen e standave me dëshmi (fotografi dhe dëshmi arkivore) për kampet e dëbim-internimit, dizenjimin, pozicionimin si dhe mbjelljen e disa fidanëve (qiparisa) për përkujtimin e fëmijëve që kanë humbur jetën nga kushtet e vështira në kampin e Tepelenës dhe janë pa një vendvarrimi. Ndërtimi i këtij Memoriali shënon vetëm hapin e parë për transformimin e të gjithë kompleksit në një Muze të Kampeve të Punës së Detyruar të Diktaturës Komuniste.

REAGIMI

Autoriteti bën me dije se "marrëveshja me PNUD-in, për programin ambicioz 'Përkujtojmë, për të shëruar dhe parandaluar' përmblidh dy ndërhyrje kryesore: (i) konceptualizimin, historinë, dhe praktikën e punës së detyruar gjatë regjimit komunist përmes një qasje historiko-juridike ndaj institucionalizimit të punës së detyruar. Kjo do të kontribuojë në konceptimin e vendeve të kujtesës si Kampi i Tepelenës dhe (II) fushatën e komunikimit 'Edhe muret kanë veshë' zbatuar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me mbështetjen e PNUD Shqipëri dhe qeverisë së Italisë". Autoriteti, bën me dije se fushata do të shtrihet në mbarë vendin, duke mbledhur dëshmi të të mbijetuarve të dënuar gjatë periudhës komuniste dhe dëshmi të solidaritetit që qytetarët e Tepelenës treguan ndaj viktimave.

Deklarata e ditës së djeshme, citon një marrëveshje me OSBE-në, për projekte hulumtimi dhe bashkëpunimi me institute e shoqata të ndryshme, si ai me Institutin e Integritetit të ish-të Përndjekurve Politikë, që mundësoi listën me të dënuarit me punë të detyrueshme në këtë kamp, 3380 persona, nga të cilët: 973 burra të moshuar, 1254 gra dhe 1163 fëmijë.



Në foto: Kampi i Tepelenës

1 javë pas debatit, njoftohet mbi ecurinë e kthimit të kampit në muze

Autoriteti shton se ka miratuar me vendim dhe me pas ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi edhe me Institutin e Historisë dhe Universitetin e Tiranës për njohjen e thelluar të së shkuarës dhe trajtimin profesional të saj.

"Brenda kuadrit ligjor mbi të cilin AIDSSH mbështet punën e vet duke pasur në themel vlerat e transparencës, integritetit, bashkëpunimit, të mësuarit dhe angazhimit. Ndërgjegjësimin e publikut përmes të mësuarit të vazhdueshëm", shton Autoriteti.

Ndërkohë, projektideja e Memorialit në kampin e dëbim-internimit të Tepelenës është ende në zhvillim. Autoriteti është i hapur për bashkëpunim me të gjithë aktorët e faktorët, në mënyrë që kampi i Tepelenës, si dëshmi e kampeve të punës së detyruar në diktaturë, të përfaqësojë një vend reflektimi për të rinjtë, studentët, qytetarët dhe të nderojë sakrificën e dinjitetin njerëzor të mijëra vetave, burra, gra e fëmijë, që u keqtrajtuuan në kampet e punës së detyruar në të gjithë vendin.

"Shqiptarët kanë nevojë për vende të tilla të kujtesës për të dënuarit e ndërgjegjes, si institucionet e burgimit apo internimit, që e kaluar të mos harrohet, të shërbejë për të kuptuar të tashmen e për të ndërthurur të ardhmen në baza më solide. Sa i takon sistemit të dëbim-internimeve, kampi i Tepelenës spikat për disa arsye:

- Ky kamp mbart qindra histori të dhimbshme njerëzore. Për shkak të situatës ekstreme të jetës, ai është përmendur në mënyrë të posaçme nga qeveria amerikane në vitin 1955, si pjesë e ankesës së saj në Kombet e Bashkuara për shkel-

jen e të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe për përdorimin e punës së detyruar si ndëshkim.

- Ai pasqyron më së miri tipologjinë e kampeve të rrethuara me tela me gjemba, të cilat nuk kanë qenë fenomen i përhapur në Lindjen Komuniste dhe mund të krahasohen vetëm me gulagët sovjetikë.

- Ndërsa për kampe të tjera të til-

la, si ai i Beratit, Krutës, Valiasit, Cërrikut, Shijakut, Porto-Palermos, Kuçovës, Kuçit të Vlorës, etj., nuk kanë mbetur objekte kujtesë, për Kampin e Tepelenës këto ekzistojnë. Disa nga kazermat e kampit të Tepelenës ruhen ende. Për më tepër, skicat e Lekë Pervizit, i mbijetuar, japin dëshmi për t'i rindërtuar kabinat ku strehoheshin të internuarit", thekson Autoriteti.

Projekti i kujtesës "Memoriali Kombëtar i Kampeve të Punës së Detyruar" është prezantuar publikisht në Tepelenë nga arkitekti Gjon

Radovani, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Autoritetit, kryetarit të Bashkisë Tepelenë, Tërmet Peçi, ambasadorit të Kombeve të Bashkuara në Tiranë, Brian Williams dhe zv/ambasadorit të Prezencës së OSBE, Robert Wilton, në praninë të mbijetuarve dhe trashëgimtarëve të tyre, qytetarëve të Tepelenës, historianëve e studentëve, përfaqësuesve të institucioneve publike dhe joqeveritare, organizatave kombëtare e ndërkombëtare dhe medias.

Autoriteti thekson se mbështet vijimësinë e punës së vet në parimet e rëndësishme, që e vënë memorien historike në themel të identitetit dhe trashëgimisë së individëve e bashkësive, si p.sh: paraqitja e këndvështrimeve të ndryshme; evitimi i shprehjeve deterministe; evitimi i përgjithësimeve; trajtimi i figurat historike si individë; sigurimi i një baze gjenue historike; përdorimi i njohurive të nivelit akademik si burime, ku gjatë punës, çdo përmblajtje duhet të ballafaqohet e të diskutohet me akademikë të njohur dhe certifikuar për njohuritë specifike dhe njohuritë e duhura për këtë punë.

"Kësisoj, në muajt në vijim, siç është përmendur edhe më lart, do të përgatitet një kuadër kërkimor mbi konceptualizimin, historinë, dhe praktikën e punës së detyruar gjatë regjimit komunist, që do të gërshetohet një qasje historiko-juridike ndaj institucionalizimit të punës së detyruar. Kjo bazë teorike do të shërbejë për nisjen e kërkimeve shkencore dhe studimeve në këtë fushë. Në këtë kontekst, do të zhvillohen ditë të hapura në universitetet të ndryshme në vend, për të informuar dhe diskutuar me studentët, kërkues shkencorë dhe profesorë mbi punën e detyruar, si dhe do të organizohet një seminar ndërkombëtar i hapur për çdo studiues, vendas apo i huaj për këtë temë" shton Autoriteti.

FATMIRA NIKOLLI

Presidentit Ilir Meta ka pritur të mërkurën një përfaqësi artistësh të kryesuar nga aktori i mirënjohur, Robert Ndrenika. Veç tij, në takim kanë qenë aktorët, Arben Derhemi, regjisorin Stefan Çapaliku dhe Taulanta Jupi.

"GSH" mësoi të martën se takimi është thirrur nga Meta, pas kërkesës publike që i bëri të hënën Robert Ndrenika.

Pas 2 muajsh protestë në mbrojtje të Teatrit Kombëtar dhe kundër projektit të ri të prezantuar nga kryeministri Edi Rama, këtë të hënë Ndrenika u shpreh: "I bëj thirrje edhe Presidentit të Republikës, të prononcohet në këtë pikë: duhet ta bëjë shteti Teatrin Kombëtar apo jo? Në të njëjtin takim, aktori i njohur "Nder i kombit" i kërkoi Ramës t'i lërë të qetë artistët.

Dy ditë pas thirrjes, takimi u mbajt dje në orën 11:00.

Vetë Presidenca, përmes një deklarate dërguar mediave bënte me dije se artistët e jno-


Projekti parasheh shembjen e godinës ekzistuese dhe ndërtimin aty të një godine trikatëshe që do të shërbejë si teatër.

hën Presidentin Meta me shqetësimin e tyre dhe të komunitetit të artistëve lidhur me problemin e godinës së Teatrit Kombëtar, që është kthyer së fundmi në një debat publik.

Injëjti njoftim, sqaron se presidenti Meta, pasi i dëgjoi me vëmendje shqetësimet e tyre, theksoi rëndësinë e dialogut të vazhdueshëm e të transparencës për këtë çështje të rëndësishme, në dobi të ruajtjes e promovimit të vlerave e trashëgimisë historike, kulturore e kombëtare.

Përtej deklaratës zyrtare "GSH" mësoi dje se aktorët i kanë kërkuar Metës që të ndërhyjë për të ruajtur godinën e Teatrit Kombëtar.

Nga ana tjetër, burime të "GSH" bëjnë me dije se presidenti ka përmtuar të zhvillojë takime për çështjen si me kryetarin e bashkisë së Tiranës edhe me institucione të tjera të përfshira në procesin e vendimmarrjes për çështjen e Teatrit Kombëtar.



INTERVISTA

Fatmira Nikolli

Martin Leka: Pengjet dhe malli për Françesk Radin e jeta e tij e trazuar

Idashur mik!
Ti ike shumë herët, shumë shpejt; si në një aksident. Nuk pate as kohë të vuaje nga sëmundja e menjëhershme. Mirësitë që bëre në jetë ta kursyen vuajtjen. Veçse u tregove pak cinik e i pabesë: ua le dhimbjen përgjithmonë Teftës, gruas së rrallë që të dashuroi (ta tha dje) atëherë kur të tjerët s'të flasin me gojë, Anjezës e Baitionit, Andetës e Rozanës, vëllait e motrave. T'i shikoje dje sa dhimbje kishin për ty, nuk do ta bëje gabimin e madh të jetës, ikjen prej tyre!

E di që nuk të vjen mirë që po të shkruaj kështu, e di edhe që do ma grisje menjëherë këtë copë letër, por unë nuk mund të rri pa të thënë dhe dy fjalë të tjera:

Ty ta shpejtuam ikjen të gjithë nga pak, ca naivë (edhe unë) e ca hipokritë:

- Që s'të kuptuam
- Që s'të dëgjua
- Që s'të njohëm mirë
- Që s'ta lexuam heshtjen
- Që s'të gjetëm "Adresën"
- Që s'të kapëm ritmin, edhe kur ti ecje me "Biçikletë"
- Që s'të bëmë "Një telefonatë zemrash" kur ti kishe nevojë...

Ndaj na mblodhe dje, si të përhumbur në terr për të na thënë: "Ky fat na ra", "Humbet pranverën"...

Ke të drejtë. Problemi nuk është me disa që ikin, por me ne të gjallët. Mbi tokë ecin shumë njerëz, por shumë pak prej tyre lënë gjurmë!

Ti, ishe ndër të paktët!
Një letër që Martin Leka i shkroi mikut të tij Françesk Radi të sapo ndarë nga jeta vitin e shkuar, shërbeu si gjenезë e një dokumentari të shfaqur në Tiranë ditën e martë. Dokumentari i realizuar nga Radio Televizioni Publik Shqiptar me skenar të Martin Lekës, flet për jetën e Françesk Radit. Përmes



Në foto: Martin Leka



Në foto: Françesk Radi

jetës së tij vjen e gjithë koha, duke nisur që nga vitet 70-'80, kur nisi censura në artin shqiptar. Në dokumentarin "Jetë e trazuar" kanë folur artistët Robert Radoja, Bujar Kapexhiu, Josif Papagjoni, Sadik Bejko, Zhan Ciko etj. Në një intervistë për "GSH", Martin Leka jep disa detaje për Radin.

- Ju vetë, si e keni njohur dhe si e keni bërë mik Françeskun?
Françeskun e kam njohur shumë herët, me muzikën që bënte! Ndërsa mik e bëra para 21 vitesh, kur të dy punonim në të njëjtin institucion, në Radio-Tirana! Si e kam bërë mik? Nuk ishte e lehtë, në fakt, sepse njerëzit e nder-

shëm, njerëzit e aftë, antikonformistët, është e vështirë t'i bësh miq! Nuk di me tej, por e kam për nder që e kisha mik! Tani fjala mik më duket aq e vogël...

- Kur të lindí ideja për një dokumentar?
Ideja lindi natyrshëm dhe nuk është ndonjë meritë! E thashë dhe

në promovim: "skenarin" e bëri vetë Franko me jetën dhe veprën e tij, të trazuar, por të bukur!

- Ka diçka në film që ju e keni shkruar në kohë. Si erdhi?

Ndoshta e keni fjalën për një pasazh nga një shkrim që bëra ditën që përcollëm Frankon?! Po. Nuk munda të flisja atë ditë

"Me kohën që ikën do mësojmë se çfarë kemi humbur me ikjen e tij"

dhe të nesërmen, siç më erdhën fjalët e dala nga shpirti, "i thashë ato s'mundja t'ia thosha dje"! Është e vështirë të mendosh fjalët në raste të tilla, në largime kaq të papritura e të pabesa! Mendon shpirti dhe kaq!

- Sa ju ka ndihmuar Tefta për realizimin e dokumentarit?

Tefta? Tefta është një histori e ekranit! Padyshim, pa atë s'do ishte bërë as filmi! Franko ka pas fat që kishte në krah një grua, ku cilësitë e saj përmbledhin vetëm në një emër: Tefta Radi!

- Pse është aq pak e përfshirë familja në të, ka qenë zgjedhje e tyre?

Njerëzit e mirë dhe modestë, është e vështirë të flasin, ndaj më shumë mund kemi mundur t'i përfshijmë në film! Nuk është çështje zgjedhjeje, është çështje cilësie, mirësie e tyre!

- A keni pengjet tuaja kundrejt tij?

Kam, në fakt! E dinë vetëm ata, që të paktën, patën turpin të mos vijnë as në varrim. Do ta mbaj për vete këtë, sepse jam i sigurtë, do më qortonte, atëherë në të gjallë në tokë e tani në qiell!

- Secili prej nesh ka një imazh të vetin për Radin. Imazhi që lë dokumentari, cili është?

NJERI, që na mungon!
- Çfarë ka që publiku nuk e di për të?

Publiku do mësojë, me kohën që ikën, se çfarë vlere ka humbur shoqëria me ikjen e Frankos!

AKTORËT: ÇFARË NA PREMTOI PRESIDENTI META PËR TEATRIN KOMBËTAR



Në foto: Takimi i djeshëm në Presidencë

Pse detyrohet Ndrenika të dalë çdo javë në media

← Të njëjtat burime, u shprehën shpresëplota që me ndërhyrjen e presidentit, mund të ndizet një dritë jeshile për kërkesat e aktorëve, që kanë kundërshtuar fuqimisht dhe në vazhdimësi projektin e propozuar nga qeveria "Rama" në muajin mars.

Projekti parasheh shembjen e godinës ekzistuese, dhe ndërtimin aty të një godine trikatëshe që do të shërbejë si teatër. Aktorët pretendojnë se teatri humbet truall me shembjen e atij që është dhe ndërtimin e të riut, truall që i kalon privatit, për të ndërtuar godina disakatëshe pas tij.

Aktorët, kanë kërkuar që godina aktuale të ruhet, pasi është pikëfillësia e çdo institucioni kul-

turor në vend për më shumë se 70 vite.

Prej muajit shkurt, si asnjëherë më parë, Robert Ndrenika, aktor i njohur dhe "Nder i kombit"- që prej vitesh refuzonte çdo dalje media-tike- ka dalë çdo javë në media për të protestuar për çështjen.

Si asnjëherë më parë, edhe artistët që lehtësisht përçahen kanë qenë të bashkuar dhe kanë folur njëzëri për vlerën e godinës dhe institucionit. Mllef i artistëve i është drejtuar disa herë kryeministrit, për shkak se ndjehen të ofenduar prej tij, jo vetëm prej ligjërimeve publike, por edhe prej mungesës së transparencës dhe përjashtimit të artistëve nga vendimmarrja për institucionin kombëtar.

"Ky njeri nuk kishte ndër-mend që të bënte TK. A e kuptoni këtë? Madje, dëshiron që ta zhdukë edhe këtë që është. Të vrasim frikën? Si vritet frika? Të hënën tjetër, ç'di kush nga ne të sjellë edhe 10 apo 50 vetë, edhe do ta vrasim frikën brenda vetes njëherë. Në rast se kemi bërë ndonjë gabim, në rast se kemi mbjellë ndonjë pemë ndonjëherë. Unë, jo! As kam ndër-mend që të mbjell", tha të hënën, Arben Derhemi. Ai shtoi se "nëse kemi marrë një lekë gabimisht edhe kemi bërë një biznes gabimisht me këta njerëz, në rast se u kemi thënë frikën gabimisht, duhet që të vrasim frikën me një katarsis brenda vetes sonë. Edhe duhet që të japim fjalën, se nuk bëhet m. Nuk bëhet më në këtë mënyrë! Nuk flitet më me këta njerëz, sepse këta janë një rus-pë e madhe, që nuk duan të dinë fare për shpirtin. A e kuptoni, që ai njeri nuk ka shpirt, pasi themeli i shpirtit është familja. Besoj se u kuptoni!"

Ndërkaq, teatri ka në krye një drejtor që i ka mbaruar mandati.

Mundësi marrëveshjeje? Zëdhënësi: Pa kaluar në parlament, s'diskutohet

Greqia: S'ka plan 'B' për çështjen e emrit të Maqedonisë

Vijon konflikti, qeveria greke e paluhatur

Zyrtarë të lartë grekë pohojnë qëndrimin e njohur tashmë të fqinjët jugor se ndryshimi i Kushtetutës është kusht i paluhatshtëm për zgjidhjen e çështjes së emrit. Zëdhënësi i qeverisë greke, Dimitris Canakopoulos, në një intervistë për mediat greke hodhi poshtë zërat për një marrëveshje të mundshme mes Shkupit dhe Athinës pa kaluar filtrat e parlamentit. Canakopoulos ishte i prerë, asnjë çështje ndërkombëtare nuk mund të zgjidhet pa marrëveshje ndërkombëtare. "Çfarë bëhet kur duhet të zgjidhet një problem bilateral? Arrin marrëveshje për një tekst juridik, që përshkruan obligimet e të dyja palëve. Respektivisht, pala greke do ta njohë fqinjin me ermin që do të biem dakord. Në mënyrë që pala greke ta njohë këtë emër dhe të marrë përsipër detyrime konkrete, një nga të është ashtu siç kemi thënë shumë herë, ndryshimi i emrit kushtetues. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë duhet të marrë përsipër obligimin juridik që ta ndryshojë emrin kushtetues, nëse duan që të arrihet marrëveshje", - deklaroi zëdhënësi i qeverisë greke, Dimitris Canakopoulos. Zëvendësministri i Jashtëm grek, Jorgos Katrugalos, nga ana tjetër ka theksuar se



Zëdhënësi i qeverisë greke, Dimitris Canakopoulos

DEKLARATA

Në mënyrë që pala greke ta njohë këtë emër dhe të marrë përsipër detyrime konkrete, një nga to është ndryshimi i emrit kushtetues. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë duhet të marrë përsipër obligimin juridik që ta ndryshojë emrin kushtetues, nëse duan që të arrihet marrëveshje".

ndryshimet kushtetuese janë të nevojshme edhe për

çrrënjosjen e çështjes së irredentizmit. "Ne dëshirojmë

që të gjitha çështjet të rregullohen përmes një marrëveshjeje ndërkombëtare, ky ishte edhe qëndrimi ynë i parë, por edhe çështja e ndryshimit të Kushtetutës, pasi duan që të mënjanohej të gjitha çështjet e lidhura me irredentizmin dhe të kemi zgjidhje gjithëpërfshirëse. Ne duam të ketë edhe karakteristika të qëndrueshme, gjë që mund të sigurohet me ndryshimin e Kushtetutës", - deklaroi Jorgos Katrugalos, zv.ministër i Jashtëm i Greqisë. Zyrtari i lartë grek në këtë kuadër ka theksuar se megjithëse ka

JORGOS KATRUGALOS

"Ne dëshirojmë që të gjitha çështjet të rregullohen përmes një marrëveshjeje ndërkombëtare, ky ishte edhe qëndrimi ynë i parë, por edhe çështja e ndryshimit të Kushtetutës, pasi duan që të mënjanohej të gjitha çështjet e lidhura me irredentizmin dhe të kemi zgjidhje gjithëpërfshirëse. Ne duam të ketë edhe karakteristika të qëndrueshme, gjë që mund të sigurohet me ndryshimin e Kushtetutës", - deklaroi Jorgos Katrugalos.

progres, zgjidhja varet nga Maqedonia, pasi Greqia nuk është nën presion dhe nuk ka përse të shpejtojë. Dimetrov dhe Kocias do të përpiqen t'i shoshitin marrëveshjet sa i përket çështjes së emrit në takimin e radhës, që pritet të mbahet më 12 prill në Shkup, njëfont "Alsat M".



Rasti "Skripal", Britania nuk e pranon përfshirjen e Rusisë në hetime

Mbretëria e Bashkuarëve ka përshkruar si "të çoroditur" propozimin rus për një hetim të përbashkët të helmimit të një ishspionit rus dhe vajzës së tij, muajin e kaluar në Sallsbëri të Anglisë. Komentet vijnë nga ekipi britanik që ndoqi një takim emergjent të Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike, në lidhje me këtë çështje. Rusia, e cila ka thirrur takimin në Hagë, dëshiron që Britania t'i ndajë provat. Britania thotë se Rusia, pothuajse me siguri, duhet fajësuar për sulmin kundër Sergei Skripalit dhe vajzës së tij Yulia, por Moskë e mohon përfshirjen. Qeveria britanike thotë se agjenti nervor Novičok, prodhim rus, është përdorur në sulmin e 4 marsit. Incidenti ka shkaktuar krizë diplomatike, shtetet përëndimore dhe Rusia i kanë dëbuar njëra-tjetra diplomatë.

Washington, Trump: Nuk jemi në "luftë" tregtare me Kinën

Presidenti amerikan, Donald Trump deklaroi përmes një postimi në "Twitter" se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ishin në një "luftë" tregtare me Kinën, disa orë pasi Pekini njoftoi rritjen e tarifave me një vlerë prej 50 miliardë dollarësh të produkteve amerikane. "Ne nuk jemi në një 'luftë' tregtare me Kinën, ajo mbetet një luftë e humbur shumë vite më parë nga drejtuesit e paaftë, të cilët përfaqësonin Shtetet e Bashkuara të Amerikës", deklaroi Trump. Pas njoftimit të Pekinit, Uashingtoni publikoi një listë të importeve kineze me vlerën e 50 miliardë dollarëve që mendohet të jenë subjekt i tarifave ndëshkuese, shkruan ata. "Tani kemi një deficit tregtar prej 500 miliardë dollarësh në vit dhe një tjetër të vjedhjes së pronës intelektuale prej 300 miliardë dollarësh. Ne nuk mund ta lejojmë këtë të vazhdojë!", tha Trump në "Twitter".

Hyryja në BE, presidenti: Progres kundër korrupsionit

Hashim Thaçi: Kosova i ka plotësuar 95 kriteret që duhen për liberalizim të vizave

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, deklaroi ditën e djeshme se janë bërë hapa konkretë në forcimin e sundimit të ligjit dhe se është bërë progres në luftën kundër korrupsionit, por ka ende për të bërë në këtë drejtim. Ai gjatë mbledhjes së Këshillit Kombëtar kundër korrupsionit e pranoi se lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit nuk është e lehtë, por ka ende punë për të bërë. "Gjatë dhjetë vjetëve të fundit Kosova ka marrë një sërë veprimesh për sundimin e ligjit. Kosova ka miratuar legjislacion për këtë fushë, Kosova ka pasur sfida në zbatimin e legjislacionit. Ky proces që ka për qëllim forcimin e mekanizmave për luftën kundër korrupsionit do të ketë mbështetjen time dhe të zyrës sime", tha ai. Presidenti Thaçi tha se në mënyrë graduale është rritur numri

HASHIM THAÇI:

"Gjatë dhjetë vjetëve të fundit Kosova ka marrë një sërë veprimesh për sundimin e ligjit. Kosova ka miratuar legjislacion për këtë fushë. Kosova ka pasur sfida në zbatimin e legjislacionit. Ky proces që ka për qëllim forcimin e mekanizmave për luftën kundër korrupsionit do të ketë mbështetjen time dhe të zyrës sime", tha ai. Presidenti Thaçi tha se në mënyrë graduale është rritur numri

ka pasur sfida në zbatimin e legjislacionit. Ky proces që ka për qëllim forcimin e mekanizmave për luftën kundër korrupsionit do të ketë mbështetjen time dhe të zyrës sime", tha ai. Presidenti Thaçi tha se në mënyrë graduale është rritur numri

i gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe është rritur buxheti për institucionet e sundimit të ligjit, raporton KP. Ndër ligjet e miratuara deri më tani në luftën kundër korrupsionit, ai përmendi ligjin për Kodin Kenal, Kodin e Proce-



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi

durës Penale, ligji për gjykatat, ai për këshillin prokurorrial, për policinë, Agjencinë Kundër Korrupsionit, ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe ligje të tjera. Kreu i shtetit po ashtu tha se Kosova i ka plotësuar tashmë 95 kri-

teret e domosdoshme për liberalizimin e vizave. Ndërkohë që kohë e fundit në Kosovë për një kohë të gjatë ka bërë bujë lajmi i deportimit të gjenistëve nga vendi gjë që ka bërë të ketë probleme me qeverinë turke.

Tokat e zëna nga ndërtimet pa leje, vendimet nga viti 2008 deri në vitin 2017

Ornela Manjani

Pronat që nuk kanë marrë kompensimin, aplikimi për 3500 dosje

Lista me përfituesit, 6 dokumentet që duhet të dorëzohen në 'Agjenci'

Pronarëve që u është zënë tona nga ndërtimet pa leje, dhe nuk kanë marrë ende kompensimin duhet të paraqiten në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave për të përfituar prej fondit prej 18.9 miliardë lekësh. Këto para do t'i përfitojnë rreth 3500 pronarë në të gjithë vendin. "Bazuar në aplikimet e kryera në ATP deri më tani për këtë proces, rezultojnë se rreth 3500 subjekte përfitues nuk janë paraqitur fare në ATP për të aplikuar me qëllim përfitimin e shpërblimit të miratuar për ta në VKM-të përkatëse. Duke qenë se ky proces nuk është i kushtëzuar dhe i limituar në kohë, ATP fton të gjithë këta subjekte përfitues që të paraqiten pranë sporteve të saj për të aplikuar me qëllim përfitimin e kompensimit të miratuar. APT, në varësi të të ardhurave të arkëtuara deri më sot për këtë proces nga ALUZIONI dhe fondeve të

vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, sipas përllogaritjeve përkatëse shpërndan aktualisht 70% të vlerës së miratuar në VKM për subjektet përfituese"-thuhet në njoftimin e Agjencisë së Trajtitimit të Pronave, të cilit i bashkëlidhet edhe lista me 3500 pronarë. Pronarëve, toka e të cilëve është zënë nga ndërtimet informale, u është njohur e drejta e kompensimit me vendim të Këshillit të Ministrave ku është përcaktuar edhe shumara për secilin, por për të

marrë paratë duhet të dorëzojnë në ATP 6 dokumente. **PROCEDURAT** Procedura e aplikimit nga subjektet përfitues është e thjeshtë. Bazuar në VKM nr.383 datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale", i indryshuar subjektet përfitues mund të paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët, për pjesën

takuese në pronën që kompensohet. Nëse kërkesa paraqitet nga një pjesë e bashkëpronarëve, ajo shpërqehet nga prokura e posaçme e nënshkruar prej tyre, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjesë të tyre, për çdo aplikim të kryer, paguhet tarifë shërbimi, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme.

DOKUMENTET

1. Kërkesën për kompensim sipas formatit tip, e cila plotësohet në ATP;
2. Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil.
3. Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre;
4. Vërtetimin e lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar;
5. Mandatpagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit;
6. Dokument identifikimi.

Emri Atësia Mbiemri	Numri i zonës kadastrale	Numri i pasurisë	Sipërfaqja e parcelës që do të shpërblehet (m ²)	Vlera tualtit	Vlera e shpërblimit (lekë)
---------------------	--------------------------	------------------	--	---------------	----------------------------

(Vijon nga numri i djeshëm)

NEVRUZ	SALI	NACELLARI	8581	10/571	57.73	635,030.00
TRASHEGIMTARET (KRESHPANJ)			8564	7/116	250.00	2,500,000.00
FERIDON	QEMAL	KUQO	3167	398/41	214.88	244,533.44
SHTEPJA RREGULLTARE E BASHKESISE MOTRAT			8594	5/579	48.00	720,000.00
FRANCESKANE TE ZOJES SE PAPERLYER						
HIXHAL		SYKJA				
KYDRETE		SYKJA	8594	9/198	235.00	1,997,500.00
MUSTAFA		SYKJA				
SKENDER		SYKJA				
XHEMAL	MALIQ	KOMBI				
ADNAN	XHEMAL	KOMBI				
VALDET	XHEMAL	KOMBI				
HAKI	SULEJMAN	HOXHA				
MEMA	SULEJMAN	BERDICA				
HEDUE	KASEM	HOXHA				
SUZANA	ADEM	HOXHA				
SULEJMAN	ADEM	HOXHA				
ERMIRA	ADEM	HOXHA				
BELKIZE	ISMAIL	RROJI				
XHEMAL	ISMAIL	HOXHA	8597	7/79	876.50	7,450,250.00
SAFETE	ISMAIL	XHINDI				
HYRJE	ISMAIL	SOKOLI				
AVDIAN	MYZAFER	HOXHA				
ERJON	REMZI	HOXHA				
MIRELA	REMZI	HOXHA				
ERMIRA	REMZI	HOXHA				
SULLTANA		HOXHA				
RUZHDI	IDRIZ	HOXHA				
SANIJE	IDRIZ	BORICI				
IXHAL	IDRIZ	BUSHATI				
MERKUZ	IDRIZ	HOXHA				
VELI		SUMA	8597	18/212	37.60	319,000.00
LEJLA		SUMA				
ELMAZE		BERDICA				
ISMAIL		BERDICA	8597	18/148	514.50	4,373,250.00
SERVETE		BERDICA				
SHEMSI		BICAKANI	8597	18/168	106.00	901,000.00
RUZHDI		SPAHIJA	8597	18/19	279.00	2,371,500.00
BAFTE		PAÇRAMI (GABA)				
GRETA		PRIFTI (LIÇOLLU)				
SAIME		PAÇRAMI	8597	7/83	600.00	5,100,000.00
FATMIR		MESI				
CUF		MESI				
SOKOL		MESI				

Emri Atësia Mbiemri	Numri i zonës kadastrale	Numri i pasurisë	Sipërfaqja e parcelës që do të shpërblehet (m ²)	Vlera tualtit	Vlera e shpërblimit (lekë)
---------------------	--------------------------	------------------	--	---------------	----------------------------

VETETIMA		SHEHU (BEGTESHI)				
BUBULLIMA		BEGTESHI (FECANI)				
YLLI		BEGTESHI	8514	4/201	19.00	418,000.00
MERITA		BEGTESHI (HAFIZ)				
ILIR		BEGTESHI				
KRISTO	FARUK	MERSINI				
BLERINA	FARUK	HOXHA				
LINDITA	FARUK	LAMÇE				
SOFIE	FARUK	MERSINI				
MEZIN		HOXHA				
SALI		HOXHA				
SHEGUSHE		HOXHA				
FIDERUSI	VEXHI	BUHARAJA				
GRETA	SABRI	BUHARAJA				
VEVHI	IBRAHIM	BUHARAJA				
MYZEJEN	VEVHI	TELEGRAFI				
MENNDUHA	VEVHI	KARAPITI				
MUZINA	VEVHI	AGO				
FERIAL	VEVHI	AMGJELI				
BYNIAMIN		HOXHA	8502	15/134	14.70	76,440.00
FERIDE		HOXHA				
FATIME		HOXHA				
SHENASI		HOXHA				
ISA	DEMIR	HOXHA				
ERVEHE	ZYLFO	LYBESHA				
BUJAR	BEDRI	LYBESHA				
ERMIRA	BEDRI	LYBESHA				
FLUTURA	NEXHMI	AGALLU				
EDUART	NEXHMI	LYBESHA				
SABRI	NEXHMI	LYBESHA				
MERUSHE	HIQMET	LYBESHA				
MIRANDA	NEXHMI	MICI				
SADIE		LYBESHA				
MAHIR		LYBESHA				
NEKI	ALI	DEKO	8541	8/85	163.00	1,956,000.00
HAMZA	MUHO	MAKBULI				
HAXHIRE		MAKBULI				
ISA		MAKBULI				
DIJE		MAKBULI				
ENVER		MAKBULI	8631	10/221	268.50	4,833,000.00
FLAMUR		MAKBULI				
ROLAND		MAKBULI				
REZART		MAKBULI				
ERGYS		MAKBULI				

(Vijon nesër)

Opinion *i* Ditës

Edi Ramën, ashtu si Berishën, do e mundë transparencja

Nga Ben Andoni

(Vijon nga faqja e parë)

... tarifimin e "Rrugës së Kombit", ndërkohë që protesta të tjera po përvijohen udhës dhe do të marrin jetë. Ballshi vlon, ndërsa pret Shkodra dhe qytete të tjera, ku problemet e varfërisë dhe ato sociale janë bërë mal.

Për të ardhur keq është se sapo

si është marrë ky vendim për njërën nga arteriet kryesore të lidhjes ndërrshqiptare, por edhe shijen e hidhur që i kish lënë mungesa e përgjigjes së kolegut të tij shqiptar, ministrin të Infrastrukturës dhe Energjetikës, z. Damian Gjoknuri.

Qeveria e Edi Ramës erdhi në pushtet me një premtim të madh. Kjo kishte të bënte me transparencën, por edhe bërjen e njerëzve

drejtoje të patrazuar, por këtë fakt ai jo vetëm e ka anashkaluar, por e ka shmangur krejtësisht. Ekonomia dhe impaktet e saj janë ato që e kanë nxjerrë zbuluar mungesën e transparencës, si edhe padobinë e qeverisë së tij. Mbi të gjitha, problemi më i madh mbetet në handikapet që ka krijuar i ashtuquajturit Partneritet Publik-Privat (PPP), fenomen, i cili në një farë mënyre ka rezultuar deri më tani me inter-

aeropotin e Vlorës dhe sesi kontrata u botua thjesht në media, check-up i shëndetësisë falas, djegiet me incenerator, zonat e lira ekonomike, vendparkimet në qytete, skanimi i kontenerëve në dogana, ngjyrosja e karburanteve, që të gjitha pra i bashkon mungesa e transparencës dhe barra mbi ekonomisë sonë kombëtare. Në ligj, riskun financiar të këtyre marrëveshjeve e mban shteti me bazën



ka filluar protesta e njerëzve lidhur me Rrugën e Kombit, politikanët kanë vërshuar ta bëjnë kauzën e tyre. Nuk kishte gjë më të shëmtuar dje, që deklaratat e para pas dhënies së verdiktit ndaj protestuesve, u dhanë nga opozita, mu asaj që lidhet me korrupsionin gjigandesk me këtë rrugë.

Çfarë i bashkon vallë të gjithë politikanët në Shqipëri? Ajo është mungesa e hapur e transparencës. Kjo e fundit është kaq banale sot, sa që deputeti socialist, kreu i Komisionit të Ekonomisë, Erion Braçe do t'ia plaste në sy kolegut të tij, ministrit Ahmetaj me fjalët: "Qeveria të kërkojë falje që nuk komunikoi me njerëzit. S'mund t'u merrni taksë banorëve të varfër të zonës, për një rrugë urbane, se ajo s'është autostradë". Përballë, pa turp, ministri bëri një ritiradë të tërë thjesht për t'u shmangur.

Pak më larg, por me të njëjtin shqetësim të ngritur, ministri kosovar i Infrastrukturës, Pal Leka do të shprehej për papajtueshmërinë me çmimin e Rrugës, mënyrën se

të vetëdijshëm për shtetin e tyre. "Rruga e rilindjes ekonomike të Shqipërisë nis nga nxjerrja në dritën e të vërtetës së gjendjes aktuale të financave shqiptare. Na duhet të dimë me saktësi një orë e më parë, sa e madhe është gropa e krijuar në buxhetin e shqiptarëve në këto vite politikash rrënuese, ekonomike e fiskale. E për këtë na duhet një analizë e thellë, objektive dhe e pavarur. Angazhimi ynë është t'i drejtohem një pale të tretë, me ekspertizë të padiskutueshme në rang ndërkombëtar. Ne po përgatitemi për ta bërë këtë me të nisur nga puna", shkruante me pathos Rama, duke marrë duartrokitje dhe besim pa fund.

Por, kanë kaluar gati katër vjet prej këtyre fjalëve, ndërsa mungesa e transparencës së qeverisë Rama është bërë gati proverbiale. Ajo ka lënë tutje dhe qeverinë e mëparshme Berisha-Meta, që dukshëm u kthye në një simbol babëzie dhe mosfunksionimi të shtetit.

Në këtë hulli, Ramës i duhej thjesht të mbante një premtim publik, atë të transparencës, që të

esa të papastra biznesi në kurriz të pasurive dhe interesave publike. Për ta justifikuar të gjithën, Edi Rama thjesht e ka modifikoi retorikën e tij me premtimet në fushatë për transparencën, porse përballja jotransparente e tyre është vërtetë e hidhur dhe pak nga pak po e barazon me paraardhësin.

Dhe, kjo edhe në rastin e Rrugës së Kombit është e evidente. Me gjithë çfarë thuhet, shpenzimet buxhetore që duhen për mbajtjen e këtij aksi nuk justifikohen, sepse aksi vetë nuk është se ndikon në rritjen ekonomike, fakt që do t'i përgjigje edhe rritja e të ardhurave nga tatimet/taksat. Sikur të mos mjaftojë kjo, falë mungesës së transparencës të qeverisë Berisha-Rama, kjo Rrugë nuk ndihet në zhvillimin e dy vendeve, pasi shkëmbimet tregtare mes Shqipërisë e Kosovës, zënë më pak se 3% të volumit të tregtisë së jashtme për të dyja vendet.

Një specialist ekonomie mund të tregojë edhe më shumë fakte për transparencën, porse është e pa-pranueshme ajo që ndodhi me

më të dobët ekonomike në Evropë, por edhe me mungesën totale të transparencës.

Kjo ishte arsyeja, që banorët skamnorë të Veriut, u hodhën në protestë duke dashur të çlirohen nga barra e taksimit të Rrugës së Kombit, që ende s'është kryer dhe që sot e kësaj dite, s'futi njeri pas hekurave me gjithë abuzimin e madh.

Raportimet periodike të KLSH-së, materialet dokumentare të rëndësishme teknike të institucioneve financiare ndërkombëtare, që monitorojnë dhe asistojnë qeverisjen e vendit, e përcaktojnë qartë se Shqipëria po pengon vetë rrugën e saj prej mungesës së transparencës me të cilën po vepron Rama dhe entourage i vet.

Dhe, sa më shumë e mohon transparencën dhe e fsheh, aq më shumë ajo të thith në atë që quhet vrima e zezë e mandatit qeverisës. Kështu filloi të bjerret Berisha me njerëzit e tij patetikë, ashtu po duket edhe Rama... Të pak-tën deri më tani.

("Gazeta Shqiptare")

HOROSKOPI

DASHI

Nëse me partnerin është krijuar pak tension, mos e vononi çështjen për ta sqaruar. Për të kthyer harmoninë do të jetë më e thjeshtë sesa mendoni! Përfitoni nga mbështetja që ju garanton familja, për të përmbyshur zgjedhjet që do të bëni.

DEMI

Nën tërheqjen e Venusit dhe Marsit, Hëna ju prish disi qetësinë dhe krijon pengesa në rrugë tuaj të gjatë. Do të merrni të promovoni një projektin tuaj të punës, tek i cili keni shumë pritshmëri. Gjasat janë që të dalë me sukses.

BINJAKET

Për shkak të veprimtimit të Hënës, dita do të jetë disi e vështirë, me shumë keqkuptime, ankesa dhe mendime jo shumë optimiste. Sot në dashuri do të jeni pak jashtë ritmi. Asgjë për t'u shqetësuar, por dëshira për t'u larguar nuk e favorizon mirëkuptimin.

GAFORJA

Rruga e gabuar dhe vonesat mund të bëjnë që të dështojë një plan. Por mos u dekurajoni, pasi keni mundësi të gjeni zgjidhje më të mira akoma! Organizoni një udhëtim: do të bëjë që të krijoni kontakte interesante me persona të panjohur.

LUANI

Nëse ndiheni të kushtëzuar nga kërkesat dhe gjykimet e një familjari, vërtini vetes objektivat që të lirohni për të marrë vendime. Duke qenë se ju pëlqen të jeni në qendër të vëmendjes, do të zbuloni se kështu do të ndiheni mirë!

VIRGJERESHA

Perfeksionizmi gëlon në venat tuaja, por do të ishte më mirë të liroheshit nga kjo, pasi ju streson dhe çon në ndikime negative në raportet profesionale. Takimi me dikë që nuk e keni parë prej shumë kohësh do të bëjë që të ndizet një flakë e vjetër pasioni.

PESHORJA

Jeni të hapur për bashkëpunime dhe të gatshëm të jepni ide të reja. Sa keq që Mërkuri angazhohet duke ju vënë shkopin në rrotë. Do të dini të vlerësoni plotësisht personin që ju rri për krahu dhe t'i kushtoni vëmendjen e duhur.

AKREPI

Mbështetja e Mërkurit, por me armiqërinë e Venusit dhe Marsit, do të bëjë që të ndiheni fajtor në frontin e dashurisë. Është e kotë të prisni ndryshime në punë. Jeni ju që duhet të bëni diçka për t'u ngritur në detyrë. Nuk mund t'ia lini më rastësisë.

SHIGJETARI

Të jeni më të dashur nuk ju bën veçse mirë. Padyshim, do të lehtësohet ndjeshëm raportet me personin që keni në krah. Mos e harroni! Ndërrhyrja e një familjari në punët tuaja do t'ju nervozojë disi, por nuk keni çfarë bëni.

BRICJAPI

Për shkak të Venusit, çështje të zemrës mund të bëjnë që të lesh pas dorë punë. Por Saturni ju tërheq vëmendjen dhe ju shtynë të keni përqendrim dhe qartësi në mendime. Nëse e kuptoni që personat që rrinë rrethë rrotull jush nuk ju përshatën, largohuni prej tyre.

UJORI

Loja e dashurisë do t'ju shtyjë të gënjejnë disi, duke shpikur ëndërra dhe iluzione, por do t'ju shërbejë për të pasur një takim edhe më të mirë. Nganjëherë përpikni të jini më të çlirë, kur nuk i kuptoni nganjëherë gjërat nga këndvështrimi i dikujt tjetër.

PESHQIT

Me Jupiterin që ju mbështet, nëse keni ndonjë ide të bukur që ju shkon ndërmend, vërtini në veprim. Do t'ia dini të jeni edhe aleatë. Nëse do të ketë fërkime brenda familjes, largojuni duke e kaluar me sportivitet.

Dje/në 'Deutsche Welle'

Nga Daniel Heinrich

Putini te Erdogani, spektakli i harmonisë

Vizita e presidentit rus, Vladimir Putin tek Recep Tayyip Erdogan synon të dëshmojë harmoni. Dy vendet janë të lidhura ngushtë në planin ekonomik, por kanë divergjencja për-sa i përket Sirisë.

Duashtërëngime, rreshe blicësh, buzëqeshje për kamerat... Konferenca e përbashkët për shtyp e Vladimir Putinit dhe Recep Tayyip Erdoganit, në krye të vizitës dy-ditore të presidentit rus, të martën pasdite në Ankara ishte për t'i dëshmuar botës harmoni. Dy krerët e shteteve donin të festonin së bashku fillimin e ndërtimit të centralit të parë bërthamor në Turqi. Sipas medias turke, impianti bërthamor që do të ndërtojë Rusia në Akuju, krahina në jug të Turqisë në brigjet e Mesdheut, kushton 20 miliardë dollarë dhe synon të mbulojë dhjetë për qind të nevojës së Turqisë për elektricitet. Nuk është bashkëpunimi i parë midis Turqisë dhe Rusisë në fushën e energjisë. Kristian Brakel, drejtori i Fondacionit "Heinrich Boell" në Stamboll, thotë për "DW" se, "Rusia është shumë e rëndësishme për tregun e gazit në Turqi, rreth 63% e gazit në Turqi vjen nga Rusia. Prej kohësh është duke u planifikuar gazsjellësi "Turkstream", me ndihmën e të cilit do të çohet gaz edhe në BE. Kjo është e dobishme për të dyja palët. Në njërin anë, Rusia dëshiron të mbetet e rëndësishme për politikën energjetike të BE-së. Në anën tjetër, Turqia dëshiron të bëhet një e rëndësishme në qarkullimin e energjisë.

GAZSJELLËSI TURKSTREAM

Turcia dhe Turqia nuk bashkëpunojnë vetëm në tregun e energjisë. Sipas Organizatës Botërore të Tregtisë (WTO), Turqia importon



vetëm nga Bashkimi Europian më shumë prodhime sesa nga Rusia. Rreth 11 për qind e importeve turke vijnë nga Rusia. Përveç naftës dhe qymyrit, prej andej eksportohet në Turqi sidomos hekur. Edhe turizmi

luan një rol të rëndësishëm. Mesatarisht rreth katër milionë rusë kalojnë çdo vit pushimet në Turqi. Ndërsa Turqia, përveç prodhimeve bujqësore, si limonë dhe fara luledielli, eksporton në Rusi kryesisht pa-

jisje për automobilë dhe anije. Sipas Divizionit Statistikor të Kombeve të Bashkuara (UNSD), në vitin 2016 këmbimi tregtar mes dy vendeve pati kapur shifrën prej 17 miliardë dollarësh.

SIRIA MBETET PIKË DELIKATE

Pavarësisht nga këto ndërthurje të ngushta ekonomike, as dy vjet e gjysmë nuk kanë kaluar që kur marrëdhëniet mes dy vendeve pësuan një krizë serioze. Në nëntor të vitit 2015, ushtria turke rrëzoi një avion luftarak rus, që kishte hyrë në hapësirën ajrore turke teksa po udhëtonte drejt Sirisë. Aeroplani u rrëzua. Një pilot vdiq. Marrëdhëniet turko-ruse vajtën në zero. Sot është mbi të gjitha rajoni Idlib në Sirinë Veriperëndimore, jo larg kufirit me Turqinë, ku bëhen të dukshme divergjencat mes Moskës dhe Ankarasë. Eksperti i Grupit Ndërkombëtar të Krizave për Sirinë, Sam Heller, është i bindur se fati i Idlibit do të vendoset në negociatat pas kuintave mes Turqisë dhe Rusisë. "Në Idlib janë grumbulluar armiqet më të mëdhenj të Asadit, prandaj Rusia mund të dojë t'i japë regjimit sirian dritë të gjelbër për ofensivë në këtë krahinë. Por ky hap - thotë Heller më tej - do të kishte pasojë të mëdha mbi Turqinë. Një ofensivë do të detyronte qindra mijëra njerëz që të kërkonin strehë përtej kufirit, në Turqi".

ZONAT E KONTROLLUARA NË SIRI

Ankaraja dëshiron ta parandalojë këtë me çdo mënyrë. Që nga viti 2016, ushtria turke kontrollon disa zona të krahinës fqinje, Aleppo. Në fund të marsit, me ndihmën e rebelëve sirianë, ajo pushtoi edhe krahinën kurde, Afrin. Në këto zona qeveria turke synon të vendosë aty një pjesë të 3,5 milionë refugjatëve sirianë që prej vitit 2011 janë strehuar në Turqi dhe gjithmonë e më shumë bëhen shkas për tensione. Për ekspertin e Sirisë, Heller, është e qartë se: "Turqia dëshiron ta mbajë Idlibin si një 'zonë tampon me luftën'".

TURQIA PËR ÇËSHTJEN "SKRIPAL"

Në fund të marsit, media njoftonte se Turqia nuk do t'u bashkojë vendimeve të shumë anëtarëve të NATO-s dhe BE-së për të dëbuar diplomatë rusë. Shumë shtete perëndimore reagoan kështu ndaj helmimit të ish-agentit të dyfishtë, Sergej Skripal, dhe vajzës së tij në Britaninë e Madhe. Megjithatë, eksperti i Turqisë, Kristian Brakel, nuk e sheh këtë paqetësi largim i Ankarasë nga Perëndimi. Ai nuk mendon se ekziston një aleancë e re ruso-turke kundër Europës. "Ka edhe shumë shtete anëtare të BE-së, si Hungaria, që nuk i dëbuan diplomatët rusë. Ky ishte më tepër një aksion i disa vendeve të bërthamës së BE-së, si Gjermania, vendet skandinave, shtetet e Beneluksit. Për palën turke është një akt balancimi. Nga njëra anë, Turqia dëshiron t'i ruajë lidhjet me Europën, e sidomos me Britaninë e Madhe, por nga ana tjetër, nuk dëshiron të zemërojë Rusinë". Ruajtja e këtij ekuilibri është si një ecje mbi litar, siç del në pah po t'u hedhim një vështrim shifrave ekonomike. Nuk është vetëm Rusia një partnere e rëndësishme ekonomike për Turqinë. Me një vëllim prej afro dymbëdhjetë miliardë dollarësh, në vitin 2016, Britania e Madhe rënditje në vendin e dytë të tregjeve të eksportit të prodhimave turke.

Kisha Katolike: Qëndrimi ynë për Rrugën e Kombit

(Vijon nga faqja e parë)

... ngjarjet që kanë ndodhur në qytetin e Kukësit si pasojë e protestës së qytetarëve për taksën e Rrugës së Kombit.

Me shpresë se do të japim kontributin tonë si pjesëmarrës në jetën sociale dhe shpirtërore të vendit ne deklarojmë sa më poshtë:

Së pari, mbështesim çdo nismë civile që kërkon të drejtat e patjetrueshme të qytetarëve. Është e drejtë e çdokujt që kur i duket e arsyeshme, të protestojë e të thotë fjalën e tij, vetëm apo i mbledhur së bashku me të tjerë.

Se dyti, ne dënojmë si moralisht të papranueshme çdo sjellje dhune ndaj personave, institucioneve, objekteve private apo shtetërore. Dhuna nuk është kurrë zgjidhje dhe ne bëjmë apel që ajo të shmanget në çdo nismë të ligjshme për kërkimin e të drejtave personale apo komunitare. "Kisha nuk mund të pranojë dhunën, sepse dhuna sjell gjith-



monë dhunë dhe prodhon në mënyrë të pashmangshme forma

të reja të shtypjes dhe të skllavërisë, më të rënda se ato që ajo

pretendonte të çlironte" (Papa Pali VI).

Së treti, ne u bëjmë apel institucioneve shtetërore të gjënë rrugët e duhura për t'u ardhur në ndihmë personave në nevojë. Jemi të vetëdijshëm se rrugët, apo çdo objekt që ka të bëjë me të mirën e përbashkët, kanë nevojë për mirëmbajtje dhe kjo duhet bërë. Por gjithashtu, sikurse e kemi shprehur edhe në letrën tonë për Krishtlindjet e vitit 2017, duhet kujdes ndaj personave, grupeve shoqërore dhe zonave që janë më në nevojë. Duhet të punojmë të gjithë bashkë në mënyrë që hendeku i krijuar midis të pasurve dhe të varfërve të ngushtohet, sidomos i atyre të zonave të thella e periferike.

E dhënë sot, më 4 prill 2018, nga Selia e Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, Tiranë Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë

TRAJNERI I FLAMURTARIT



Trajnieri i Flamurtarit, Shpëtim Duro, u shpreh se fitorja e sotme ndaj Skënderbeut ishte shumë e diskutueshme. Në fjalët e tij për "SuperSport", ai deklaroi edhe se penalltia e sotme ishte e çuditshme, si shumë të tjera kundër ekipit vlonjat. "Skuadra ka qenë jashtëzakonisht e ngarkuar për arsye të rezultateve, është mëse normale. Megjithatë, skuadra ka funksionuar si skemë, ka bërë gabime edhe

Duro: Për Kupën do firmosja që në fillim, Jorgji dha penallti të lehtë

në pasime të thjeshta. Nëse do të ishim më të qetë, ndoshta do të shkonim më mirë, por edhe kështu është mirë. Alvesh? Ka humbur shumë raste në të gjitha ndeshjet, do të isha i kënaqur nëse shënonte të dytin, bravo i qoftë për atë

gol. Edhe në ndeshjen me Kukësin, e kam thënë që në të gjitha parametrat ishim shumë mirë. Sot (dje) ishte mbulimi i hapësirave kryesore, sepse kjo është treshja e sulmit të Skënderbeut, nuk ka mungesa. Ne kemi një muaj e gjysmë që kemi

6-7 mungesa, edhe sot (dje) na mungonin Bushiç e Zhufo. E kam thënë që ky sezon, nëse mbyllet me fitimin e Kupës, do të kisha firmosur që në fillim të vitit. Më mirë një trofe se Europa nëpërmjet vendit të dytë apo të tretë, se trofeu mbahet mend. Penalltia? E dha shumë lehtësisht, edhe djemtë e thanë. Na ndihmoi fati që u humb. Do ua dija për faleminderit gjyqtarëve të më jepnin një penallti".

Laçi dhe Kukësi ndahen në paqe të bardhë në ndeshjen e parë. Kualifikimi vendoset në Kukës

Flamurtari "bën ligjin" në Korçë

Vlonjatët thyejnë Skënderbeun, finalja më parë



Jeton Selimi

Flamurtari fiton ndeshjen e parë në Korçë ndaj Skënderbeut, duke hedhur themele të shëndosha për kalimin në finale. Vlonjatët kanë arritur të thyejnë bardhekuqtë me një gol të vonë të brazilianit Danilo Alvesh, duke korrur një sukses me peshe. Çuditërisht ndeshja nuk u ndoq nga ndonjë numër i madh tifozësh, ndërsa të dyja ekipet bënë gabime të shumta. Por edhe Enea Jorgji nuk mbeti pas, teksa në minutën e 28-të akordoi një 11-metërs të paqenë për të zotët e shtëpisë, kur Xhejms rrezohet në zonë nga një gjoja kontakt me Sidiben. Nga pika e bardhë u paraqit Gjergj Muzaka, i cili shih goditjen e tij t'i grushtohet nga Nurkoviç, ndërsa me topin e kthyer është mbrojtja që tregohet

KUPA E SHQIPËRISË	
TË MËRKURËN	
Laçi - Kukësi	0-0
Skënderbeu - Flamurtari	0-1
KTHIMI, 18 PRILL	
Kukësi - Laçi	
Flamurtari - Skënderbeu	



met e një këndoreje dhe me kokë thyen Teqen për epërsinë e skuadrës së Shpëtim Duros. Muzaka

mund të kishte barazuar në minutën e 88-të, por çuditërisht gjuan jashtë me kokë, ndonëse gjendet i pashqetë-

suar në zonën e rreptësisë. Me këtë sukses, Flamurtari ka bërë një hap të rëndësishëm drejt finaleve të Kupës së Shqipërisë, pasi ndeshja e dytë do të luhet në Vlorë pas dy javësh.

LAÇI-KUKËSI

Nuk pati fitues në gjysmë-finalen e parë të Kupës së Shqipërisë. Laçi dhe Kukësi u ndanë në barazim pa gola në sfidën e vajtjes, duke lënë të hapur kualifikimin për në finale, për përballjen e dytë që do të luhet në fushën e kampionëve në fuqi të Superligës. Ndoshta ky ishte dhe rezultati më i drejtë për atë që dhuruan skuadrat në fushën e lojës sidomos në pjesën e parë. E gjithë loja u përgjendrua në mesin e fushës, teksa si vendësit, ashtu edhe miqtë e drejtuar nga Peter Pakult rrezikuan pak për të mos thënë aspak por-

tat respektive. Për t'u veçuar në pjesën e parë është tensioni në fundin e saj. Një përplasje në fushë e Musollit me Shtubinën ka sjellë reagimin e tifozëve që kanë hedhur sende të forta në fushë. Atmosfera u qetësua pas pushimit, ndërsa në pjesën e dytë, të dyja skuadrat ishin më kërkuese. Në fillim Kukësi rrezikoi me shumë me aksionet sulmuese, madje miqtë gjetën edhe rrugën e rrejtës në minutën e 73-të, por goli i tyre u anulua për një ndërhyrje të gabuar të sinjaluar nga arbitri. Minutat e fundit ishin për Laçin, por edhe finalizimi i vendësve la për të dëshiruar, ndërsa dy skuadrat u ndanë pa gola dhe duhet të presin sfidën e kthimit për të vendosur se cila prej tyre do të luajë në finale të Kupës së Shqipërisë.

TRAJNERI I SKËNDERBEUT

Skënderbeu humbi në shtëpi përballë Flamurtarit ndeshjen e parë gjysmëfinale të Kupës së Shqipërisë me rezultatin 0-1, ndërkohë që për këtë ndeshje foli trajneri Ilir Daja. Në një prononcim për "Supersport", ai u shpreh se në këtë ndeshje kanë ndikuar mungesat, ndërkohë që pranon se edhe dënimi i UEFA-s ka pasur ndikim, pasi futbollistët janë të shokuar. "Penalltia? Është i vetmi element që ne nuk e përcaktojmë dhe nuk mendojmë ndonjëherë që do të marrim penallti. Penalltinë nuk kishim vendosur se kush do ta godasë dhe kjo ishte pjesë e mosmarrëveshjes së Muzakës me Gavazajin. Kemi bërë një lojë me dy 'fytyra' dhe kjo ndeshje më jep qetësi pas asaj performancë që kemi bërë në

Daja: Penalltia? Nuk e dinim në do na jepej. Nuk iki nga Skënderbeu



Shkodër. Në pjesën e dytë kemi prishur gjithçka dhe mund të them se ekipi ende nuk është ullur me këmbë në tokë. Kemi bërë një hap fals në shtëpi, por nuk jemi dorëzuar dhe them se në ndeshjen e ardhshme do të kemi një ndeshje të fortë. Dënimi? Unë jam trajner i Skënderbeut dhe ndihem i respektuar që drejtoj këtë ekip dhe them është hera e parë që Shqipëria kalon 4 ture dhe shkon në Europë.

Ka vetëm ndeshje të dyshuara dhe nuk ka asgjë të vërtetuar. Është një Skënderbe që kohën e fundit ka qenë ekipi më i mirë shqiptar qoftë në fair play, apo kudo dhe nuk mund të priset kjo vetëm nga dyshime. Unë do vazhdoj të jem trajner i Skënderbeut, sepse ndihem mirë në këtë qytet dhe me këtë ekip. Çdo lojtar të kundërshtarit e vlerësoj për atë që jep në kampionat, por mua më dalin dhe më teprojnë futbol-


listë e ekipit tim. Ne duhet të përshtatem me këtë vendim që është marrë në UEFA dhe duhet t'ua lëmë kompetentëve të merren me këtë vendim, ndërsa ne duhet të merremi vetëm me futboll. Sot na munguan disa titullarë dhe me rikthimin e tyre do të kemi më shumë mundësi për të kaluar këtë shok që kemi. Mungesat? Sigurisht që mungesat janë të rëndësishme, duke filluar nga Shehi, që është lider në fushë, për të vazhduar me Radas apo Jashanicën, të cilin duhet ta lëmë të qetë se ku është, për të vazhduar me Lilajn. Është gati komplet boshti i ekipit, me Shehin, Radasin që i jep qetësi lojës tonë, me Osmanin që spohetohet para e Lilajn. Janë të gjithë lojtarë që kanë peshë te ekipi. Me kthimin e tyre do të kemi më shumë mundësi të bëjmë në ndeshjen e dytë, atë që nuk bëjmë në të parën", u shpreh Daja.

TRAJNERI I KUKËSIT

Pakult: Goli ynë ishte i rregullt. Tani mendjen te Kamza

Trajnieri i Kukësit, Peter Pakult, për barazimin e sotëm në fushën e Laçit u shpreh se është i kënaqur me faktin se skuadra e tij nuk ka pësuar gol, por ka rezervë për lojën. Sipas tij, Kukësi gaboi në pasimet e shkurtra dhe nuk bëri lojën e zakonshme, ndërkohë që golin e anuluar e konsideron të rregullt. Pas ndeshjes ai u shpreh: "Para ndeshjes ishim të bindur se do të ishte e vështirë, sepse e di që në këtë fushë është shumë e vështirë të marrësh rezultat. E dinim që do të shpenzohim shumë energji. Luftuam, por sot nuk luajtëm shumë futboll. Ka rëndësi që nuk pësuan gol dhe presim ndeshjen e kthimit. Me zeron prapa jam i kënaqur, por duhet të shënonim në këtë ndeshje. Laçi nuk na la shumë të luanim, sepse ishte agresiv, por më shumë jam i pakënaqur nga ekipi im, sepse gabaam në pasimet e thjeshta e nuk arritëm të bënim lojën e zakonshme. Nuk është se deshmë të bllokoni Uzunin apo Sefgjinin. Nuk është se e ndërtoj strategjinë e ndeshjes, duke iu përshtatur kundërshtarit. Idrizin e vendosa në sulm, pasi Zherdriç kthehej nga dëmtimi. Mendova të shfrytëzoni shpejtësinë e Idrizit dhe ai shënoi, pavarësisht se goli i anulua. Për ndeshjen e kthimit nuk dua fare të mëndoj, sepse kemi përpara Kamzën, një ndeshje shumë e fortë. Koliçi? Desha ta shoh në këtë ndeshje dhe tani e di se kush do të jetë në portë në ndeshjen me Kamzën".

Fjalëkryqi (1)



34. Pak analogji.
35. Eshhtë vdekje e autorizuar.
39. Një numër femrash.
42. Në krye të modernistëve.
43. Kërkojnë talent.
44. Mbetet në fund.
45. U vra me një grushngn nga Odiseu
47. Bëhet në start.
49. Catherine aktore.
50. Ishte babai i Odiseut
- VERTIKAL**
1. I famshëm ai i Trojës.
2. Një...FIAT.
3. Mbyllin një hark.
4. Eshhtë si sarkazmë.
5. Fillojnë ideologjinë.
6. Ushtrohet me cd false.
7. Në këtë moment.
8. King Cole i muzikës.
11. Janë si cilësi.
12. Fillojnë nazet.

- HORIZONTAL**
1. Mund të jetë një arkë.
8. Fillojnë ndeshjen
9. Paul që këndonj Diana.
10. Spagna që këndon en Itali.
13. Fillojnë lojen.
14. Gjysmë tepsie
17. Mund të jenë ekspres.
18. Qe babai i mjekësisë.
21. Eshhtë si ballon.
22. Lind një në kokë.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Një pjesë e edukatës.
27. Inicialet e Asimov.
28. Eshhtë e vrara në kufhtë.
30. Iglit e Lazio.
31. Inicialet e Redford.
33. Mbetet në fund.

15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. Janë binarët.
18. Nënkuptojnë edhe pranga.
19. Aktet pa kufij.
20. I takojnë fituesit.
21. Quinn aktor.
22. Pak inekzistente.
23. Fillojnë dobët.
24. Rrjeshtohen në kuvertë.
29. Eshhtë divorci.
32. Një pije piratësh.
33. Zanore për perime.
36. Një peshki i rëndë.
37. Enti amerikan i hapësirës.
38. Yll anglez.
40. Gripi paa ekstreme.
41. Tiran pa kufij.
46. Në hyrje të oazit.
48. Fillojnë ilustrimet.


Fjalëkryqi (2)




- HORIZONTAL**
1. Marple a Agatha Christie.
4. Zanore për zulu.
6. Qyteti i Protagora-s.
11. Inicialet e Lendl ish tenist.
12. Janë tek në kufij.
14. Benigni aktor.
16. Mund të jetë me mbret.
18. Gjysmë ndkim.
20. Një dru aromatik.
21. Teke trari.
23. Janë me numër të tilla ushtarake.
24. Nusja pa çifte.
25. Iglit e Lazio.
26. Një pjesë e sipërfaqes.
27. Një fjalë... para kohe
28. Janë mashtrime... me grim.
31. Duken të gjata në pritje.
32. Skuadra merengue.
33. Eshhtë trofe sportiv.

34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshe.
39. Kalohen në gjumë.
42. Kanë dhoma për t'u zënë.
44. Një treshe në skenë.
46. As unë, as ai.
47. Aq duhet t'i bëjnë sytë vigjilentët.
48. Gjysmë armate.
- VERTIKAL**
1. Një legjendë.
2. Përfundojnë një stil.
3. Shkruhen për filma.
5. Janë malet ruse të tilla
6. Agjenci Botuese Lokale.
7. Një kontestues i viteve shatërdhjetë.
8. Një krye të drejtuesve.
9. Eshhtë racë kombi.
10. Steiger aktor.
13. I vihen kalit.
15. Një britmë në corrida.
16. Një gjellë gratis.
17. Rolet pa zë.
19. Eshhtë e hollë dhe therëse.
20. Një brejtës pylli.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për gol.
27. Janë maskarenj.
28. Tre në tetëdhjetë.
29. Emri i parë i Fassbinder.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
34. Eshhtë Organoziata e skuadrave të Formula 1.
35. Mbyllin punimet.
37. Ndoth në kufij.
38. Një përhuur.
40. Pak tradicionale.
41. Një cigan.
43. Fillojnë lehtë.
45. Mbyllin një manastir.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	6		1	5		8		
1								3
		2	7		4	1		
9			4	1	3			6
		7				5		
6			5	7	9			4
		4	9		1	3		
2								8
	9		8		6		7	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	2	3	8	5	7	1	4	9
5	8	7	4	9	1	6	3	2
4	1	9	3	2	6	7	5	8
2	7	8	6	1	5	3	9	4
9	3	6	7	8	4	2	1	5
1	4	5	9	3	2	8	7	6
3	9	4	1	6	8	5	2	7
8	5	1	2	7	9	4	6	3
7	6	2	5	4	3	9	8	1

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVEVE TË NUMRIT TË KALUAR

A	R	K	S	I	K	E	N	D	E	T		
T	R	U	P	N	M	K	Q	E	N	I		
A	M	A	R	C	E	L	P	R	O	U	S	T
A	J	A	D	R	I	E	N	R	U	B		
R	E	A	L	M	O	L	P	I	P	P	O	
G	R	E	M	I	N	E	T	A	P	A	T	
D	L	E	L	A	R	H	E	R	A			
L	T	E	A	R	K	A	H	M	N			
E	L	H	A	N	E	S	O	R	E	A	I	
S	A	A	D	I	T	E	N	D	E	R	K	I
I	E	R	A	T	A	P	A	P	A			

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	I	Z	A	T	E	K	I	P	E	T			
P	A	R	I	M	E	T	A	M	I	T	A		
A	M	I	N	T	E	M	A	T	I	K	E		
K	I	S	K	O	M	U	N	I	T	A	R	E	
E	A	P	A	R	A	L	E	L	I	E	P		
T	D	A	N	A	T	M	E	I					
A	K	O	M	A	S	T	R	A	F	E	T	A	T
T	A	M	I	L	P	I	R	A	T	I	E		
P	A	R	E	T	I	E	T	L	E	T			
G	O	T	T	I	N	A	A	D	E	T	I		
R	E	S	P	A	P	L	A	N	I				
A	N	T	I	P	A	T	I	K	E	T	K	E	

Argëtim filozofik

- Mediokriteti nuk njih asgjë më të lartë se veten e vet. (A. Konan Dojl)
- Asnjë nuk është e vogël për një mendje të madhe. (Sherlok Holms)
- Për të njohur vetveten, duhet ditur gjithçka për të tjerët. (Oskar Uajltd)



Thënie të mënçura

- Njerëzit e mirë janë gjithmonë të parët... që zhgënjehen... sepse venë shpirtin në çdo gjë që bëjnë... por kurrë nuk duhet të përfillosh nga durimi i tyre... sepse janë të fundit që lodhen... por dhe të parët që nuk kthehen prapa...
- I dua njerëzit që kanë mbetur në jetën time, ma bënë jetën të mrekullueshme, i falënderoj edhe njerëzit që u larguan nga jeta ime, ma bënë jetën fantastike...
- Në botë ka njerëz që kanë para... dhe njerëz që janë të pasur...

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

